


Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë





Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë

Titulli i origjinalit:

Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area
European Association for Quality Assurance in Higher Education, Helsinki, 2005.

Ky raport u përkthye si pjesë e projektit “Promovimi i Procesit të Bolonjës në Kosovë” që implementohet nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) në partneritet me Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Lubjanës (Slloveni) dhe me Universitetin e Peloponezitet (Greqi).



Education and Culture

Tempus

Ky projekt është financuar nga Komisioni Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e plotë e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe, në asnjë rrethanë, nuk duhet t'i atribuohet Komisionit.

Hyrje

Në Komunikatën e Berlinit të dt. 19 shtator 2003 ministrat e vendeve nënshkruese të Procesit të Bolonjës i bënë ftesë Rrjetit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) që, “përmes anëtarëve të vet, e në bashkëpunim me EUA, EURASHE dhe ESIB”, të zhvillojë “një sistem të dakorduar standardesh, procedurash dhe udhëzimesh për sigurimin e cilësisë” dhe “të hulumtojë mundësitë për të ndërtuar një sistem adekuat të sigurimit të cilësisë të bazuar në vlerësimin e jashtëm dhe/ose në agjenci apo trupa akreditimi, si dhe t’i raportojë për këtë, përmes Grupit Përcjellës të Bolonjës, ministrave në vitin 2005”. Po ashtu, ministrat kanë kërkuar nga ENQA “t’i kushtojë vëmendje të duhur ekspertizës së asociacioneve dhe rrjeteve të tjera për sigurimin e cilësisë”.

Ky raport paraqet përmbushje të këtij mandati dhe gëzon përkrahjen e të gjitha organizatave të emëruara në Komunikatë. Pajtueshmëria e tillë është rezultat i frymës së bashkëpunimit dhe respektit të ndërsjellë që karakterizoi diskutimet në mes të palëve të përfshira. Prandaj, dëshiroj t’i shpreh falënderimet e mia për EUA, EURASHE dhe ESIB, si dhe për agjencitë anëtare të ENQA për kontribut të çmuar procesit.

Ky raport i drejtohet ministrave evropianë të arsimit. Megjithatë, ne presim që raporti të qarkullohet me gjerë në mesin e atyre që kanë interes për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Shpresojmë se lexuesit do ta shikojnë raportin të dobishëm dhe inspirues.

Duhet theksuar se raporti nuk është më shumë sesa hapi i parë në një rrugë të gjatë për krijimin e një sistemi të përbashkët të vlerave, të pritshmërive dhe të praktikave pozitive në raport me cilësinë dhe sigurimin e saj, nga institucionet dhe agjencitë anekënd Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL). Puna që është filluar me mandatin e Berlinit duhet të vazhdojë më tutje, nëse dëshirohet të sigurohet një dimension funksional evropian i sigurimit të cilësisë për HEAL. Nëse kjo mund të arrihet, do të arrihen edhe shumë ambicie të Procesit të Bolonjës. Të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces shpresojnë se do të mund të kontribuojnë që përpjekjet tona të rezultojnë me sukses.

Christian Thune

President i ENQA

shkurt 2005

Përmbajtja

| | |
|---|-----------|
| Përmbledhje ekzekutive | 5 |
| 1 Konteksti, qëllimet dhe parimet..... | 9 |
| 2 Standardet evropiane dhe udhëzimet..... | 11 |
| Hyrje në standarde dhe udhëzime..... | 11 |
| Hyrje në pjesën e parë dhe të dytë: Standardet evropiane dhe udhëzimet për vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së arsimit të lartë | 13 |
| Pjesa e parë: Standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë | 15 |
| Pjesa e dytë: Standardet evropiane dhe udhëzimet për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë | 20 |
| Hyrje në pjesën e tretë: Standardet evropiane dhe udhëzimet për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë..... | 24 |
| Pjesa e tretë: Standardet evropiane për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë | 24 |
| 3 Sistemi i vlerësimit profesional për agjencitë për sigurimin e cilësisë | 28 |
| Konteksti ndërkombëtar | 29 |
| Vlerësimet ciklike të agjencive | 30 |
| Regjistri i agjencive për sigurimin e jashtëm të cilësisë që veprojnë në Evropë..... | 32 |
| Forumi Konsultativ Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë..... | 33 |
| 4 Perspektivat dhe sfidat e së ardhmes | 34 |
| Shtojcë: Vlerësimi ciklik i agjencive për sigurimin e cilësisë - një model teorik | 36 |

Përmbledhje ekzekutive

Ky raport është hartuar nga Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA)¹, përmes anëtarëve të tij, në konsultim me EUA, ESIB dhe EURASHE dhe në diskutim me rrjete të ndryshme relevante. Ai paraqet përmbushje të mandatit të dyfishtë që i është dhënë ENQA me Komunikatën e Berlinit të shtatorit të vitit 2003 që të zhvillohet “një sistem të dakorduar standardesh, procedurash dhe udhëzimesh për sigurimin e cilësisë” dhe “të hulumtohen mundësi për të ndërtuar një sistem adekuat të sigurimit të cilësisë të bazuar në vlerësimin e jashtëm dhe/ose në agjenci apo trupa akreditimi”.

Raporti përbëhet nga katër kapituj. Pas kapitullit hyrës për kontekstin, qëllimet dhe parimet, vijojnë kapituj për standarde dhe udhëzime për sigurimin e cilësisë²; sistemi i vlerësimit profesional për agjencitë për sigurimin e cilësisë; dhe perspektivat dhe sfidat në vijim.

Rezultatet dhe rekomandimet kryesore të raportit janë:

- Do të ketë standarde evropiane për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë dhe për agjenci të jashtme për sigurimin e cilësisë.
- Agjencitë për sigurimin e cilësisë në Evropë duhet t'i shtrohen vlerësimit ciklik brenda pesë vitesh.
- Theksi do të jetë në subordinim, ndërsa vlerësimi do të bëhet në nivel kombëtar sa herë që të jetë e mundur.
- Do të hartohet regjistri evropian i agjencive për sigurimin e cilësisë.
- Komiteti i Regjistrimit Evropian do të jetë organi që do të vendosë për përfshirjen e agjencive në regjistër.
- Do të krijohet një Forum Konsultativ Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Me zbatimin e rekomandimeve:

- Do të përmirësohet konsekuenca e sigurimit të cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL) me përdorimin e standardeve dhe udhëzimeve të dakorduara.
- Institucionet e arsimit të lartë dhe agjencitë për sigurimin e cilësisë në HEAL do të kenë pika të përbashkëta referimi për sigurimin e cilësisë.
- Regjistri do të lehtësojë identifikimin e agjencive profesionale dhe të besueshme.

¹ Asambleja e Përgjithshme e ENQA konfirmoi më 4 nëntor 2004 transformimin e Rrjetit Evropian në Asociacion Evropian.

² Termi “sigurim i cilësisë” në këtë raport ka të bëjë me proceset si vlerësimi, akreditimi dhe auditimi

- Procedurat për njohjen e kualifikimeve do të përforcohen.
- Do të shtohet kredibiliteti i punës së agjencive për sigurimin e cilësisë.
- Këmbimi i pikëpamjeve dhe përvojave në mes të agjencive dhe palëve të tjera me interes (përfshirë institucionet e arsimit të lartë, studentët dhe përfaqësuesit e tregut të punës) do të forcohet përmes punës në Forumin Konsultativ Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë.
- Shtohet mirëbesimi në mes të institucioneve dhe agjencive.
- Ndhimohet lëvizja drejt njohjes së ndërsjellë.

Lista përmbledhëse e standardeve evropiane për sigurimin e cilësisë

Kjo listë përmbledhëse e standardeve evropiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë është nxjerrur nga kapitulli 2 i raportit dhe është vendosur këtu për ta bërë më të lehtë referimin. Nga kjo janë hequr udhëzimet shoqëruese. Standardet përbëhen prej tri pjesëve dhe mbulojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucione të arsimit të lartë, sigurimin e jashtëm të cilësisë së arsimit të lartë, si dhe sigurimin e cilësisë të agjencive për sigurimin e jashtëm të cilësisë.

Pjesa e parë: Standardet evropiane dhe udhëzimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë brenda institucioneve të arsimit të lartë

1.1. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë: Institucionet duhet të kenë politikë dhe procedura për sigurimin e cilësisë, si dhe standarde për programet dhe thirrjet që ofrojnë. Ato duhet të përkushtohen shprehimisht për zhvillimin e një kulture që njeh rëndësinë e cilësisë dhe të sigurimit të cilësisë në punën e tyre. Për të arritur këtë, institucionet duhet të zhvillojnë dhe të zbatojnë një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat duhet të kenë status formal dhe të publikohen. Ato, po ashtu, duhet të definojnë rolin e studentëve dhe të palëve me interes.

1.2. Aprovimi, monitorimi dhe vlerësimi periodik i programeve dhe: Institucionet duhet të kenë mekanizma formalë për aprovimin, vlerësimin periodik dhe monitorimin e programeve dhe thirrjeve të tyre.

1.3. Vlerësimi i studentëve: Studentët duhet të vlerësohen përmes kriterëve, rregullave dhe procedurave të publikuara që zbatohen me konsekuencë.

1.4. Sigurimi i cilësisë së personelit mësimdhënës: Institucionet duhet të kenë forma për t'u siguruar se personeli i përfshirë në mësimdhënie ka kualifikime dhe kompetenca për punë me studentë. Ato forma duhet të jenë të hapura ndaj vlerësimeve të jashtme dhe duhet të komentohen në raporte.

1.5. Burimet për mësim dhe përkrahja e studentëve: Institucionet duhet të sigurohen se burimet e nevojshme për

të përkrahur studentët në procesin e mësimit janë adekuate dhe të përshtatshme për çdo program që ofrohet.

1.6. Sistemet informative: Institucionet duhet të mbledhin, të analizojnë dhe të shfrytëzojnë informata relevante për menaxhim efektiv të programeve të tyre të studimeve dhe të aktiviteteve të tjera.

1.7. Informimi i publikut: Institucionet duhet të publikojnë rregullisht informata të përditësuara, të paanshme dhe objektive, si sasiore ashtu edhe cilësore, për programet dhe thirrjet që ofrojnë.

Pjesa e dytë: Standardet evropiane për sigurimin e jashtëm të cilësisë së arsimit të lartë

2.1. Përdorimi i procedurave interne për sigurimin e cilësisë: Procedurat për sigurimin e jashtëm të cilësisë duhet të marrin parasysh efektshmërinë e proceseve të brendshme për sigurimin e cilësisë të përshkruara në Pjesën e parë të Standardeve Evropiane dhe Procedurave.

2.2. Zhvillimi i proceseve për sigurim të jashtëm të cilësisë: Qëllimi dhe objektivat e proceseve për sigurimin e cilësisë duhet të përcaktohen para se të zhvillohen vet proceset nga të gjithë ata që janë përgjegjës (përfshirë institucionet e arsimit të lartë) dhe duhet të publikohen bashkë me përshkrimin e procedurave që do të shfrytëzohen.

2.3. Kriteret për vendimmarrje: Çdo vendim formal i marrur si rezultat i aktivitetit të vlerësimit të jashtëm duhet të bazohet në kritere të qarta dhe të publikuara që zbatohen me konsekuencë.

2.4. Proceset që i përgjigjen qëllimit: Të gjitha proceset për sigurim të jashtëm të cilësisë duhet të përcaktohen me saktësi për të siguruar se janë adekuate për arritjen e qëllimeve dhe objektivave përkatëse.

2.5. Raportimi: Raportet duhet të publikohen dhe të shkruhen me një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për publikun lexues të synuar. Çdo vendim, lëvdatë ose rekomandim duhet të gjendet lehtë nga lexuesi.

2.6. Procedurat për veprim të mëtutjeshëm: Proceset për sigurimin e cilësisë që përmbajnë rekomandime për veprim ose që kërkojnë një plan veprimi, duhet të kenë procedura të paracaktuara për veprim të mëtutjeshëm që zbatohen me konsekuencë.

2.7. Vlerësimet periodike: Veprime për sigurimin e jashtëm të cilësisë së institucioneve dhe/ose programeve duhet të ndërmerren në cikle. Kohëzgjatja e ciklit dhe procedurat e vlerësimit duhet të jenë mirë të definuar dhe të publikohen paraprakisht.

2.8. Analizat në nivel të sistemit: Agjencitë për sigurimin e cilësisë duhet të përgatisin kohë pas kohe raporte përmbledhëse që shpjegojnë dhe analizojnë përfundimet e përgjithshme të vlerësimeve, vlerësimeve, analizave, etj.

Pjesa e tretë: Standardet evropiane për agjencitë për vlerësim të jashtëm të cilësisë

3.1. Përdorimi i procedurave të jashtme për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë: Agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë duhet të marrin parasysh prezencën dhe efektshmërinë e proceseve për sigurimin e jashtëm të cilësisë të shpjeguara në Pjesën e dytë të Standardeve Evropiane dhe Udhëzimeve.

3.2. Statusi zyrtar: Agjencitë duhet të njihen formalisht nga autoritete publike në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë si agjenci me përgjegjësi për sigurim të jashtëm të cilësisë dhe duhet të kenë bazë të qartë juridike. Ato duhet t'i respektojnë kërkesat e sistemit juridik brenda të cilit veprojnë.

3.3. Aktivitetet: Agjencitë duhet të ndërmarrin aktivitete për sigurim të jashtëm të cilësisë (në nivel të institucionit apo programit) në baza të rregullta.

3.4. Burimet: Agjencitë duhet të kenë burime adekuate dhe proporcionale, si njerëzore ashtu edhe financiare, për të qenë në gjendje të organizojnë dhe vejnë në veprim proceset e tyre të sigurimit të jashtëm të cilësisë në mënyre të efektshme dhe efikase, duke i kushtuar rëndësi të duhur zhvillimit të proceseve dhe procedurave të tyre.

3.5. Deklarata e misionit: Agjencitë duhet të kenë qëllime dhe objektiva të qarta për punën e tyre që janë pjesë e një deklarate të publikuar.

3.6. Pavarësia: Agjencitë duhet të jenë të pavarura si deri në masën e nevojshme për të bartur përgjegjësi autonome për veprimin e tyre, ashtu edhe në masën e nevojshme që përfundimet dhe rekomandimet e bëra në raportet e tyre të mos mund të ndikohen nga palë të treta siç janë: institucionet e arsimit të lartë, ministrinë ose palët tjera me interes.

3.7. Kriteret e jashtme për sigurimin e cilësisë dhe proceset që përdoren nga agjencitë: Proceset, kriteret dhe procedurat që përdoren nga agjencitë duhet të parafinohen dhe të jenë të publikuara. Normalisht, këto procese do të përfshijnë:

- procedura të vetëvlerësimit ose procedura ekuivalente nga subjekti i procesit të sigurimit të cilësisë;
- vlerësimin e jashtëm nga një grup i ekspertëve, që, sipas nevojës, përfshin edhe anëtarë studentë dhe vizita në terren nëse ashtu vendosë agjencia;
- publikimin e një raporti, përfshirë çfarëdo vendime, rekomandime ose rezultate të tjera formale;
- procedurë për veprim të mëtutjeshëm për të vlerësuar veprimet e subjektit të procesit të sigurimit të cilësisë në dritën e rekomandimeve të raportit.

3.8. Procedurat e llogaridhënies: Agjencitë duhet të kenë procedura për llogaridhënie vetanake.

1 Konteksti, qëllimet dhe parimet

Në Komunikatën e Berlinit të dt. 19 shtator 2003 ministrat e vendeve nënshkruese të Procesit të Bolonjës i bënë ftesë Rrjetit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) që, “përmes anëtarëve të vet, e në bashkëpunim me EUA, EURASHE dhe ESIB”, të zhvillojë “një sistem të dakorduar standardesh, procedurash dhe udhëzimesh për sigurimin e cilësisë” dhe “të hulumtojë mundësitë për të ndërtuar një sistem adekuat të sigurimit të cilësisë të bazuar në vlerësimin e jashtëm dhe/ose në agjenci apo trupa akreditimi, si dhe t’i raportojë për këtë, përmes Grupit Përcjellës të Bolonjës, ministrave në vitin 2005”. Po ashtu, ministrat kanë kërkuar nga ENQA “t’i kushtojë vëmendje të duhur ekspertizës së asociacioneve dhe rrjeteve të tjera për sigurimin e cilësisë”.

ENQA e ka mirëpritur këtë mundësi për t’i dhënë kontribut domethënës zhvillimit të dimensionit evropian në sigurimin e cilësisë, duke i avancuar kështu qëllimet e Procesit të Bolonjës.

Kjo punë ka përfshirë shumë organizata të ndryshme dhe grupe interesi. E para, anëtarët e ENQA janë përfshirë gjerësisht në këtë proces. Anëtarët kanë marrur pjesë në grupe të punës dhe draft-raportet e tyre kanë qenë pjesë e rëndësishme e agjendës së Asambleve të Përgjithshme të ENQA në qershor dhe në nëntor të vitit 2004. E dyta, Asociacioni i Universiteteve Evropiane (EUA), Asociacioni Evropian i Institucioneve të Arsimit të Lartë (EURASHE), Unionet Nacionale të Studentëve në Evropë (ESIB) dhe Komisioni Evropian kanë marrur pjesë përmes takimeve të rregullta në punën e “Grupit E4”³. E treta, kontakti me rrjete të tjera dhe kontributi i tyre, si Konsorciumi Evropian për Akreditim (ECA) and Rrjeti i i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë të Evropës së Mesme dhe Lindore (Rrjeti CEE), ka qenë ndihmesë e madhe në procesin e hartimit të raportit. Përfundimisht, ENQA dhe partnerët e saj i kanë shfrytëzuar mjaft mirë kontaktet e tyre ndërkombëtare dhe përvojën e tyre dhe, në këtë mënyrë, kanë arritur të sigurojnë pasqyrimin e perspektivave relevante ndërkombëtare në këtë proces.

Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë nuk është kurrësi vetëm çështje evropiane. Në mbarë botën vërehet një interesim i shtuar për cilësinë dhe për standardet që reflektojnë rritje të shpejtë të arsimit të lartë dhe të shpenzimeve publike dhe private që bëhen për të. Prandaj, nëse Evropa dëshiron t’i arrijë aspiratat për të qenë ekonomia botërore më dinamike dhe e bazuar në dije (Strategjia e Lisbonës), arsimit të lartë në Evropë duhet të dëshmojë se e merr me seriozitet cilësinë e programeve dhe të thirrjeve dhe se është i gatshëm të përcaktojë rrugë për sigurimin dhe dokumentimin e kësaj cilësie. Nismat dhe kërkesat që paraqiten në Evropë dhe jashtë saj në formë të internacionalizimit të arsimit të lartë kërkojnë një përgjigje. Përkushtimi i të gjithë atyre që janë përfshirë në hartimin

³ E4 është shkurtesa që përdoret për forumin e përbërë nga EUA, EURASHE, ENQA dhe ESIB.

e këtyre propozimeve premton jetësimin e dimensionit evropian për sigurimin e cilësisë, i cili do ta bëj më tërheqëse ofertën e arsimit të lartë në HEAL.

Propozimet e dhëna në këtë raport mbështeten nga një numër parimesh që përshkruhen në hollësi në dy kapitujt që kanë të bëjnë me dy aspektet e mandatit të Berlinit. Sidoqoftë, disa parime fundamentale përshkojnë tërë punën e bërë:

- interesi i studentëve dhe i punëdhënësve, si dhe i tërë shoqërisë, për arsim të lartë cilësor;
- rëndësia e madhe e autonomisë institucionale, në kombinim me vetëdijen se ajo sjell me vete përgjegjësi të madhe;
- nevoja që sigurimi i jashtëm të cilësisë t'i shërbejë qëllimit të vet dhe që, për realizimin e qëllimeve të veta, t'i ngarkojë institucionet vetëm aq sa ka nevojë.

HEAL-in me 40 shtetet e saj e karakterizon diversiteti i sistemeve politike, i sistemeve të arsimit të lartë, i traditave socio-kulturore dhe edukative, i gjuhëve, i aspiratave dhe i pritshmërive. Kjo e bën të papërshtatshme qasjen monolite ndaj cilësisë, standardeve dhe sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Në dritën e këtij diversiteti dhe varieteti, që njihet si një ndër vlerat evropiane, raporti pozicionohet kundër qasjes së ngushtë, normative dhe të formuluar ndaj standardeve. Si në pjesën e standardeve ashtu edhe në atë të udhëzimeve, raporti favorizon parimin gjenerik për kërkesat specifike. E bën këtë sepse beson se kjo qasje ka më shumë gjasa të pranohet fillimisht në shkallë të gjerë dhe do të ofrojë një bazë më të fortë për bashkimin e komuniteteve të ndryshme të arsimit të lartë në HEAL. Standardet gjenerike duhet të jenë më të pranueshëm në nivel kombëtar⁴ në shumicën e shteteve nënshkruese. Sidoqoftë, një pasojë e parimit gjenerik është se standardet dhe udhëzimet përqendrohen më shumë në atë që duhet bërë sesa në atë se si do të arrihen. Prandaj, raporti përmban çështje procedurale, por i jep përparësi standardeve dhe udhëzimeve, veçanërisht në kapitullin 2.

Më në fund, duhet theksuar se arritja e pajtimit për këtë raport nuk është njëlloj si të arrihet qëllimi i Bolonjës për sigurimin e cilësisë si dimension i veçantë i HEAL. Mbetet shumë për t'u bërë për t'i jetësuar rekomandimet e këtij raporti dhe për të ndërtuar një kulturë të cilësisë të institucionet e arsimit të lartë dhe agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë.

⁴ Në raport termi “kombëtar” përfshin edhe kontekstin regional në kuptim të agjencive për sigurimin e cilësisë, të konteksteve dhe autoriteteve kombëtare, etj.

2 Standardet evropiane dhe udhëzimet

Mandati i dhënë nga ministrat që të zhvillohet “një sistem i dakorduar standardesh, procedurash dhe udhëzimesh për sigurimin e cilësisë” ka ngritur një numër pyetjesh me rëndësi. “Sigurimi i cilësisë” është term gjenerik në arsimin e lartë dhe mund të interpretohet në shumë mënyra të ndryshme: nuk është e mundur që të gjitha rrethanat e mundshme të përmbliidhen në një definicion të vetë. Ngjashëm, fjala “standard” përdoret në mënyra të ndryshme në Evropë, duke filluar nga deklaratat që përcaktojnë kërkesat e ngushta rregullatore, deri te përshkrimet më të përgjithësuar të praktikave më të mira. Shprehjet kanë, po ashtu, kuptime të ndryshme në kontekste lokale të sistemeve nacionale të arsimit të lartë.

Për më tepër, vet procesi i hartimit të këtij dokumenti ka treguar se, brenda vet komunitetit që merret me sigurimin e cilësisë, ekzistojnë dallime qenësore në perceptimin e raportit adekuat që duhet të ndërtohet në mes të institucioneve të arsimit të lartë dhe vlerësuesve të jashtëm. Disa prej tyre, në veçanti nga agjencitë për akreditimin e programeve ose institucioneve, konsiderojnë se sigurimi i jashtëm i cilësisë është, në thelb, çështje e “mbrojtjes së konsumatorit”, që kërkon një distancë të përcaktuar qartë në mes të agjencisë për sigurimin e cilësisë dhe institucioneve të arsimit të lartë punën e të cilëve e vlerëson ajo, përderisa agjenci të tjera e kuptojnë sigurimin e jashtëm të cilësisë si formë këshillëdhënie në procesin e përmirësimit të standardeve dhe të cilësisë së programeve të studimit dhe të kualifikimeve gjegjëse. Situata e përshkruar kërkon një raport të afërt në mes të vlerësuesit dhe të vlerësuarit. Ndërkaq, të tjerët synojnë një pozicion të ndërmjetëm, duke balancuar në mes të llogaridhënies dhe përmirësimit.

Nuk kanë vetëm agjencitë për sigurimin e cilësisë këndvështrime të ndryshme ndaj kësaj çështjeje. Interesat e institucioneve të arsimit të lartë dhe të përfaqësuesve të studentëve nuk përputhen gjithnjë, sepse institucionet kërkojnë një nivel më të lartë të autonomisë me një minimum të rregullimit të jashtëm ose të vlerësimit (në nivel të vet institucionit), ndërsa studentët kërkojnë që institucionet të japin llogari para publikut përmes inspektimeve të vazhdueshme në nivel të programeve dhe të kualifikimeve.

Përfundimisht, standardet dhe udhëzimet ndërlidhen vetëm me të tri ciklet e arsimit të lartë si janë përshkruar në Deklaratën e Bolonjës dhe nuk kanë për qëllim të mbulojnë fushën e kërkimit shkencor ose të menaxhimit të përgjithshëm të institucioneve.

Hyrje në standarde dhe udhëzime

Kjo ndarje e raportit përmban sistemin e standardeve dhe të udhëzimeve të propozuara për sigurimin e cilësisë në HEAL. Standardet dhe udhëzimet janë përgatitur që të jenë të zbatueshme në të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe në agjencitë për sigurimin e cilësisë në Evropë, pa marrë parasysh strukturën e tyre, funksionin dhe madhësinë, si dhe pa marrë parasysh sistemet nacionale brenda të cilave operojnë. Si është theksuar më herët, nuk është quajtur e

udhës që rekomandimet e këtij kapitulli të raportit të përmbajnë “procedura” të detajuara, sepse procedurat e institucioneve dhe të agjencive janë pjesë e rëndësishme e autonomisë së tyre. Është çështje e institucioneve dhe e agjencive dhe e bashkëpunimit të tyre në kontekst individual se cilat do të jenë pasojat procedurale të adoptimit të standardeve të dhëna në këtë raport.

Si pikënisje, standardet dhe udhëzimet bazohen në “Deklaratën e Gracit të korrikut 2003” të Asociacionit të Universiteteve Evropiane (EUA), e cila thekson se “ qëllimi i dimensionit evropian të cilësisë është të promovojë mirëbesimin në ndërsjellë dhe të përmirësojë transparencën duke respektuar diversitetin e konteksteve nacionale dhe të fushave të studimit”. Në pajtim me Deklaratën e Gracit, standardet dhe udhëzimet e këtij raporti njohin përparësinë e sistemeve nacionale të arsimit të lartë, rëndësinë e autonomisë së institucioneve dhe të agjencive brenda këtyre sistemeve nacionale, si dhe kërkesat e veçanta të fushave të ndryshme akademike. Përveç kësaj, standardet dhe procedurat i detyrojnë shumë përvojës së fituar gjatë projektit pilot “Projekti për vlerësimin transnacional evropian” (TEEP) të koordinuar nga ENQA, i cili hulumtoi implikimet operationale të proceseve transnacionale evropiane të vlerësimit në tri disiplina.

Standardet dhe procedurat, po ashtu, marrin parasysh studimin mbi konvergjencën e cilësisë publikuar nga ENQA në mars të vitit 2005, i cili ka hulumtuar arsyet për dallime në mes të qasjeve të ndryshme ndaj sigurimit të jashtëm të cilësisë në nivel nacional dhe kufizimeve rreth konvergjimën e tyre. Më tutje, ato reflektojnë deklaratat e ministrave në Komunikatën e Berlinit se “në pajtim me parimet e autonomisë institucionale, përgjegjësia parësore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë është e vet institucionit dhe, kështu, jepet një bazë reale për llogaridhënien reale të sistemit akademik brenda kornizës nacionale të kualifikimeve”. Prandaj, përmes këtyre standardeve dhe udhëzimeve është kërkuar një balancë adekuate në mes të krijimit dhe zhvillimit të kulturës për sigurimin e brendshëm të cilësisë, dhe rolit që mund të kenë procedurat e jashtme të sigurimit të cilësisë.

Përveç kësaj, standardet dhe udhëzimet kanë përfituar edhe nga “Kodi i praktikës së mirë” publikuar në dhjetor 2004 nga Konsorcium Evropian për Akreditim (ECA) dhe perspektivat tjera të përfshira në “Deklaratën për standardet, procedurat dhe udhëzimet e dakorduara në nivel evropian” (prill 2004) dhe në “Deklaratën për vlerësimin profesional të agjencive për sigurimin e cilësisë dhe akreditimin” (prill 2004) të ESIB, në “Deklaratë për politikën e sigurimit të cilësisë në kontekstin e Komunikatës së Berlinit” (prill 2004) të EUA, dhe në “Deklaratën e politikave për Procesin e Bolonjës” (qershor 2004) të EURASHE. Përfundimisht, perspektiva ndërkombëtare është përfshirë përmes krahasimit të standardeve për sigurimin e jashtëm të cilësisë me “Udhëzimet për praktikën më të mira” që zbatohen nga Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (INQAAHE).

Hyrje në pjesën e parë dhe të dytë: Standardet evropiane dhe udhëzimet për vlerësim të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së arsimit të lartë

Standardet dhe udhëzimet për vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm që janë dhënë në vijim, janë hartuar për përdorim nga institucionet e arsimit të lartë dhe agjencitë për sigurimin e cilësisë nga HEAL dhe mbulojnë fushat kyçe që lidhen me cilësinë dhe me standarde.

Qëllimi i këtyre standardeve dhe udhëzimeve është që të ndihmojnë dhe të orientojnë institucionet e arsimit të lartë në procesin e zhvillimit të sistemeve të tyre të sigurimit të cilësisë, si dhe agjencitë që bëjnë vlerësimin e jashtëm të cilësisë, e, po ashtu, të kontribuojnë në krijimin e një kornize të përbashkët referimi që do të mund të përdorje prej tyre. Nuk është qëllimi që këto standarde dhe udhëzime të imponojnë praktika, ose të interpretohen si preskriptive dhe të pandryshueshme.

Në disa vende të HEAL, përgjegjësia për fushat që mbulojnë standardet dhe udhëzimet i takon ministrive ose organizmave ekuivalentë. Në situata të tilla, ministria ose organizmi duhet të sigurojë që mekanizmat për sigurimin e cilësisë të jenë funksionalë dhe t'i shtrohen shqyrtimeve të pavarura.

Parimet themelore

Standardet dhe udhëzimet bazohen në disa parime themelore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në HEAL, si nga brenda, ashtu edhe nga jashtë. Këto janë:

- bartësit e arsimit të lartë kanë përgjegjësinë më të madhe për cilësinë e punës së tyre dhe për sigurimin e cilësisë;
- duhet mbrojtur interesin shoqëror për standardet e sigurimit të cilësisë;
- cilësia e programeve të studimit duhet të zhvillohet dhe të përmirësohet për studentët dhe përfituesit tjerë të arsimit të lartë nga gjithë HEAL;
- është e nevojshme të sigurohen struktura organizative efikase dhe efektive për zbatimin dhe mbështetjen e këtyre programeve akademike;
- transparenca dhe shfrytëzimi i ekspertizës së jashtme për sigurimin e cilësisë janë me rëndësi;
- duhet inkurajuar krijimin e kulturës për sigurimin e cilësisë brenda institucioneve të arsimit të lartë;
- duhet zhvilluar procese përmes të cilave institucionet e arsimit të lartë do të mund të dëshmojnë përgjegjshmërinë, përfshirë përgjegjshmërinë për investimin e parasë private dhe publike;
- sigurimi i cilësisë me qëllim të llogaridhënies është plotësisht në përputhje me sigurimin e cilësisë me qëllim të avancimit të punës;
- institucionet duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë cilësinë e tyre në vend dhe në rrafshin ndërkombëtar;

- proceset nuk duhet të jenë pengesë për llojllojshmëri dhe risi.

Qëllimet e standardeve dhe udhëzimeve

Qëllimet e standardeve dhe udhëzimeve janë:

- të përmirësohet arsimimi i studentëve në institucionet e arsimit të lartë në HEAL;
- të ndihmohen institucionet e arsimit të lartë në menaxhimin dhe ngritjen e cilësisë, duke u ndihmuar kështu që ta justifikojnë autonominë e tyre institucionale;
- të krijohet baza për punën e agjencive për sigurimin e cilësisë;
- të bëhet më transparent dhe më i kuptueshëm për të gjithë sigurimi i jashtëm i cilësisë.

Objektivat e standardeve dhe udhëzimeve

Objektivat e standardeve dhe udhëzimeve janë:

- të inkurajojnë zhvillimi i institucioneve të arsimit të lartë që nxisin aktivitete dinamike intelektuale dhe arsimore;
- të ofrojnë një burim i asistencës dhe këshillimit për institucionet e arsimit të lartë dhe për agjenci të tjera relevante për zhvillimin e kulturës së sigurimit të cilësisë;
- të informojnë dhe të shtojnë pritshmëritë e institucioneve të arsimit të lartë, të studentëve , të punëdhënësve dhe të palëve me interes për proceset dhe rezultatet e arsimit të lartë;
- të kontribuojnë ndërtimit të një kornize të përbashkët referente për ofrimin e arsimit të lartë dhe sigurimin e cilësisë brenda HEAL.

Sigurimi i jashtëm i cilësisë

Standardet dhe udhëzimet e rekomanduara në këtë raport i japin rol me rëndësi për sigurimin e jashtëm të cilësisë. Format e saj dallojnë prej një sistemi në tjetrin dhe mund të përfshijnë vlerësime institucionale të tipeve të ndryshme; vlerësime të lëndëve ose të programeve; akreditime në nivel të lëndëve, të programeve ose të institucioneve; si dhe kombinime të këtyre. Efektiviteti i plotë i vlerësimeve të tilla të jashtme varet nga ekzistimi i strategjisë eksplicite për sigurimin e brendshëm të cilësisë me objektiva specifike, si dhe nga përdorimi brenda institucioneve i mekanizmave dhe metodave për arritjen e këtyre objektivave. Sigurimi i cilësisë mund të bëhet nga agjenci e jashtme për shumë qëllime, përfshirë:

- ruajtja e standardeve akademike kombëtare për arsimin e lartë;
- akreditimi i programeve dhe/ose i institucioneve;
- publikimi i të dhënave për programet ose institucionet (sasiore dhe cilësore) të verifikuara nga burimi i pavarur;

- përmirësimi dhe ngritja e cilësisë.

Aktiviteti i agjencive evropiane për sigurimin e cilësisë do të reflektojë kërkesat ligjore, shoqërore dhe kulturore të juridiksioneve dhe mjediseve ku ato veprojnë. Standardet evropiane lidhur me lidhur me sigurimin e cilësisë të vet agjencive për sigurimin e cilësisë janë dhënë në pjesën e tretë të këtij kapitulli.

Proceset që zbatohen nga agjenci për sigurimin e cilësisë do të varen nga qëllimi i tyre, si dhe nga efektet e dëshiruara. Procedurat e adoptuara nga agjenci që kanë për qëllim ngritjen e cilësisë mund të jenë të ndryshme nga ato që kanë të qëllim të ofrojnë një shkallë të lartë të “mbrojtjes së konsumatorëve”. Standardet në vijim reflektojnë praktikën më të mirë evropiane në procesin e sigurimit të jashtëm të cilësisë, por nuk kanë për synim të jenë udhëzime të hollësishme për atë që duhet analizuar ose për atë se si duhet bërë sigurimin e cilësisë. Këto janë çështje të autonomisë kombëtare, megjithëse këmbimi i informacionit në mes të agjencive dhe të autoriteteve gjegjëse tanimë po rezulton me praninë e elementeve konvergjuese.

Sidoqoftë, janë disa parime të përgjithshme të praktikave më të mira të proceseve për sigurimin e jashtëm të cilësisë:

- duhet të respektohet autonomia institucionale;
- interesat e studentëve dhe të palëve të tjera me interes siç janë përfaqësuesit e tregut të punës duhet të jenë në fokusin e proceseve për sigurimin e jashtëm të cilësisë;
- sa herë që është e mundur duhet të shfrytëzohen rezultatet e aktiviteteve për sigurimin e brendshëm të cilësisë.

“Udhëzimet” ofrojnë informacion plotësues për praktikën e mira dhe, në disa raste, shpjegojnë në hollësi kuptimin dhe rëndësinë e standardeve. Edhe pse udhëzimet nuk janë pjesë e vet standardeve, standardet duhet të shihen të lidhura me to.

Pjesa e parë: Standardet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë

1.1 Politikën dhe procedurat për sigurimin e cilësisë

Standardi:

Institucionet duhet të kenë politikë dhe procedura të ndërlidhura për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve dhe gradave që japin. Ato duhet të përkushtohen qartë për zhvillimin e kulturës që njih rëndësinë e cilësisë dhe të sigurimit të cilësisë në punën e tyre. Për të arritur këtë, institucionet duhet të zhvillojnë dhe të zbatojnë strategji për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë.

Strategjia, politika dhe procedurat duhet të kenë status formal dhe të bëhen publike. Ato duhet të parashohin edhe rol për studentë dhe palët tjera me interes.

Udhëzimet:

Politikat dhe procedurat formale përbëjnë një kornizë brenda së cilës institucionet e arsimit të lartë mund të zhvillojnë dhe të monitorojnë efektivitetin e sistemeve të tyre për sigurimin e cilësisë. Po ashtu, ato ndihmojnë të krijohet një besueshmëri ndaj autonomisë institucionale të publiku. Politikat paraqesin deklarata të qëllimeve dhe burimet kryesore me të cilat këto qëllime do të arrihen. Udhëzimet për procedurat mund të japin informacion më të detajuar për mënyrat e implementimit të politikave dhe paraqesin pikë referimi për ata që dëshirojnë të dinë për aspekte praktike të zbatimit të këtyre procedurave.

Politikat duhet të përshkruajnë:

- raportin në mes të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në institucion;
- strategjinë e institucionit për cilësi dhe standarde;
- organizimin e sistemit për sigurimin e cilësisë;
- përgjegjësinë e departamenteve, shkollave, fakulteteve, njësive të tjera akademike dhe individëve për sigurimin e cilësisë;
- përfshirjen e studentëve në sigurimin e cilësisë;
- mënyrat për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave.

Realizimi i HEAL varet drejtpërdrejtë nga përkushtimi në të gjitha nivelet e institucioneve për të siguruar se programet e tyre kanë rezultate të dëshiruara të definuara qartë dh në mënyrë eksplicite; se personeli është i gatshëm, i vullnetshëm dhe i aftë për të përkrahur mësimdhënien dhe nxënien që do t'i ndihmojë studentët t'i arrijnë këto rezultate; se vlerësohet plotësisht, me kohë dhe në mënyrë të dukshme kontributi i personelit që demonstroi përsosmëri, ekspertizë dhe dedikim. Të gjitha institucionet e arsimit të lartë duhet të aspirojnë të përmirësojnë dhe të avancojnë arsimin që u ofrojnë studentëve të tyre.

1.2 Aprovimi, monitorimi dhe vlerësimi periodik i programeve dhe gradave

Standardi:

Institucionet duhet të kenë mekanizma formalë për aprovim periodik dhe për monitorim të programeve dhe të gradave të tyre.

Udhëzimet:

Besimi i studentëve dhe i palëve të tjera me interes ndaj arsimit të lartë mund të ndërtohet dhe të mbahet më lehtë përmes aktiviteteve efektive për sigurimin e cilësisë që sigurojnë se programi është mirë i ndërtuar, se monitorohet me rregull dhe vlerësohet periodikisht, duke siguruar në këtë mënyrë relevancë të vazhdueshme.

Sigurimi i cilësisë i programeve dhe i gradave nënkupton:

- zhvillimin dhe publikimin në mënyrë eksplicite të rezultateve të pritshme të të nxëniet;

- kujdes të vazhdueshëm ndaj procesit të zhvillimit dhe përmbajtjes së kurrikulit dhe programeve;
- nevojat specifike të formave të ndryshme të organizimit të studimeve (p.sh. studimet e rregullta, me korrespondencë, në distancë, e-learning) dhe tipeve të ndryshme të arsimit të lartë (p.sh. akademik, teknik, profesional);
- sigurimin e burimeve adekuate për mësim;
- procedura formale për aprovimin e programeve nga trupa tjerë prej atyre që zbatojnë programin;
- monitorimi i progresit dhe të arriturat e studentëve;
- vlerësime të rregullta periodike të programeve (përfshirë anëtarë të jashtëm të paneleve);
- sigurimi i vazhdueshëm i informatës kthyesë nga punëdhënësit, përfaësuesit e tregut të punës dhe organizata të tjera relevante;
- pjesëmarrja e studentëve në aktivitete për sigurimin e cilësisë.

1.3 Vlerësimi i studentëve

Standardi:

Studentët duhet të vlerësohen në bazë të kriterëve, rregullave dhe procedurave të bëra publike e që zbatohen me përpikëri.

Udhëzimet:

Vlerësimi i studentëve është një ndër elementet më të rëndësishme të arsimit të lartë. Rezultatet e vlerësimit kanë efekt të ndjeshëm në karrierën e studentit. Prandaj, është me rëndësi që vlerësimit gjithnjë të bëhet në mënyrë profesionale dhe të mbajë parasysh njohurinë ekzistuese për testimin dhe proceset e ekzaminimit. Po ashtu, vlerësimi ofron informacion relevant për institucionin për efektivitetin e përkrahjes për mësimdhënie dhe nxënie.

Procedurat për vlerësimin e studentëve duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të jenë të ndërtuara ashtu që të matin arritjen e rezultateve të dëshiruara të të nxënit dhe të objektivave të tjera programore;
- t'i përgjigjen qëllimit për të cilin janë krijuar, qofshin diagnostike, formative ose sumative;
- të kenë kritere të qarta dhe të publikuara për notim;
- të zbatohen nga njerëz që kuptojnë rolin e vlerësimit në avancimin e studentit drejt arritjes së njohurive dhe shkathtësive të lidhura me kualifikimin e dëshiruar;
- sa herë që është e mundur, të mos bazohen në gjykimin e një vlerësuesi të vetëm;
- të mbajnë parasysh të gjitha pasojat e mundshme të rregullativës së vlerësimit;

- të përmbajnë rregullativë të qartë për veprim në rastet e mungesës së studentit, sëmundjes dhe situatave të tjera lehtësuese;
- të sigurojnë që vlerësimi të bëhet në pajtim me procedurat e deklaruara nga institucioni;
- të verifikohen në aspektin administrativ për të siguruar besueshmërinë e procedurave.

Për më tepër, studentë duhet të informohen për strategjinë e vlerësimit që përdoret për programin e tyre, çfarë provime dhe metoda të tjera vlerësimi do të përdoren, çfarë mund të presin prej tyre, dhe cilat kritere do të zbatohen për vlerësimin e performancës së tyre.

1.4 Sigurimi i cilësisë së personelit mësimdhënës

Standardi:

Institucionet duhet të kenë mënyra për t'u siguruar se personeli i përfshirë në mësimdhënie është i kualifikuar dhe kompetent për këtë detyrë. Personeli duhet të jetë në dispozicion të atyre që bëjnë vlerësimin e jashtëm dhe të komentojë raportet e tyre.

Udhëzimet:

Mësimdhënësit janë burimi më i rëndësishëm i informacionit për shumicën e studentëve. Është me rëndësi që mësimdhënësit të kenë njohuri të plotë dhe të kuptojnë lëndën që mbajnë, si dhe të kenë shkathtësi dhe përvojë të caktuar për ta transmetuar njohurinë dhe të kuptuarit e tyre te studentët në kontekste të ndryshme të mësimdhënies. Po ashtu, mësimdhënësit duhet të jenë të njohur me informatën kthyesë për performancën e tyre. Institucionet duhet të sigurohen se procedurat e rekrutimit dhe të emërimit bëjnë të mundur që personeli i ri ka minimumin e kompetencës së nevojshme. Personeli mësimor duhet të ketë mundësi për të zhvilluar dhe avancuar kapacitetin e vet për mësimdhënie dhe duhet inkurajuar të vlerësojë shkathtësitë e veta. Institucionet duhet t'i ofrojnë mësimdhënësve “të dobët” mundësi që t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre deri në një nivel të pranueshëm, si dhe duhet të kenë mënyra për t'i larguar nga procesi mësimor nëse vazhdojnë të jenë shprehimisht joefektive.

1.5 Burimet për mësim dhe përkrahja e studentëve

Standardi:

Institucionet duhet të sigurojnë se burimet në dispozicion për të përkrahur të nxënit e studentëve janë adekuate dhe të përshtatshme për çdo program që ofrohet.

Udhëzimet:

Përveç në mësimdhënës, studentë mbështeten në një varg burimesh që ndihmojnë të nxënit. Ato ndryshojnë nga burime fizike siç janë bibliotekat ose sallat kompjuterike, deri te përkrahja njerëzore në formë të instruktorëve,

këshilltarëve, etj. Burimet për nxënie dhe mekanizma të tjerë përkrahës duhet të jenë në dispozicion të studentëve, të jenë të ndërtuara në bazë të nevojave të tyre, si dhe të jenë të ndjeshme ndaj informatës kthyesë nga shfrytëzuesit e shërbimeve. Institucionet duhet të monitorojnë, vlerësojnë dhe përmirësojnë në mënyrë rutinore efektivitetin e shërbimeve përkrahëse në dispozicion të studentëve të tyre.

1.6 Sistemet informative

Standardi:

Institucionet duhet të sigurojnë mbledhjen, analizën dhe përdorimin e informatave relevante për menaxhim efektiv të programeve të studimeve dhe të aktiviteteve të tjera.

Udhëzimet:

Njohja vetanake e institucionit është pikënisje për sigurim efektiv të cilësisë. Është me rëndësi që institucionet të kenë mjete për mbledhje dhe analizë të informatave për aktivitetet e tyre vetanake. Pa këtë, ato nuk mund të dinë se çfarë funksionon mirë e çfarë kërkon vëmendje, ose cilat janë rezultatet e praktikave inovative.

Sistemet informative lidhur me cilësinë që kërkohen nga institucione individuale do të varen, deri në një masë, nga nevojat lokale, por, të paktën pritet të mbulojnë:

- progresin e studentëve dhe kalueshmërinë;
- punësueshmërinë e të diplomuarve;
- kënaqësinë e studentëve me programet e tyre;
- efektivitetin e mësimdhënies;
- profilin e popullacionit studentor;
- burimet për mësim që janë në dispozicion dhe koston e tyre;
- treguesit vetanakë të performancës së institucionit.

Krahasimi i institucioneve me organizata të ngjashme brenda HEAL dhe më gjerë është një vlerë tjetër. Kjo i mundëson institucioneve që të mësojnë më shumë për vetveten, duke përmirësuar kështu performancën e tyre.

1.7 Informimi i publikut

Standardi:

Institucionet duhet të publikojnë me rregull informata të përditësuara, të paanshme dhe objektive, sasiore dhe cilësore, për programet dhe për gradat që ofrojnë.

Udhëzimet:

Për të përmbushur rolin e tyre publik, institucionet e arsimit të lartë kanë përgjegjësi të ofrojnë informacion për programet që ofrojnë, për rezultatet e tyre të pritshme të të nxëniet, për kualifikimet që ofrojnë, për mësimdhënien, nxënien dhe procedurat e vlerësimit që përdorin, si dhe për mundësitë për nxënie që janë në dispozicion të studentëve. Informacioni i publikuar mund të përfshijë edhe qëndrimet dhe informatat për punësimin e ish-studentëve, si dhe profilin e popullacionit studentor të tanishëm. Ky informacion duhet të jetë i saktë, i paanshëm, objektiv dhe me mundësi të menjëhershme qasjeje, si dhe nuk duhet të përdoret vetëm si formë marketingu. Institucioni duhet të verifikojë se ky informacion i plotëson kriteret e tij lidhur me paanësinë dhe objektivitetin.

Pjesa e dytë: Standardet evropiane dhe udhëzimet për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë

2.1 Përdorimi i procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë

Standardi:

Procedurat për sigurimin e jashtëm të cilësisë duhet të marrin parasysh efektivitetin e proceseve të brendshme për sigurimin e cilësisë të përshkruara në pjesën e parë të Standardeve evropiane dhe udhëzimeve.

Udhëzimet:

Standardet për sigurimin e brendshëm të cilësisë të prezantuara në pjesën e parë ofrojnë një bazë të vlefshme për proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Është me rëndësi që politikat dhe procedurat e brendshme të institucioneve të vlerësohen me kujdes përmes procedurave të vlerësimit të jashtëm, në mënyrë që të përcaktohet shkalla e arritjes së standardeve.

Nëse institucionet e arsimit të lartë janë në gjendje të dëshmojnë efektivitetin e proceseve të brendshme për sigurimin e cilësisë dhe nëse këto procese e sigurojnë cilësinë në mënyrë adekuate, atëherë proceset e jashtme mund të jenë më pak intensive se zakonisht.

2.2 Zhvillimi i proceseve për sigurimin e jashtëm të cilësisë

Standardi:

Qëllimet dhe objektivat e proceseve për sigurimin e cilësisë duhet të përcaktohen para se të jenë zhvilluar proceset nga ata që janë përgjegjës (përfshirë institucionet e arsimit të lartë), si dhe duhet të publikohen bashkë me përshkrimin e procedurave që do të përdoren.

Udhëzimet:

Për hir të qartësisë së qëllimit dhe transparencës së procedurave, metodat për sigurimin e jashtëm të cilësisë duhet të disenjohen dhe të zhvillohen përmes proceseve që përfshijnë palët kryesore me interes, përfshirë institucionet e arsimit të lartë. Procedurat e dakorduara duhet të publikohen dhe të përmbajnë deklaram implicit të qëllimeve dhe objektivave të proceseve, si dhe përshkrimin e procedurave që do të përdoren.

Meqë sigurimi i jashtëm i cilësisë paraqet ca kërkesa karshi institucioneve të përfshira, duhet të bëhet një analizë preliminare e impaktit për të siguruar se procedurat e adoptuara janë adekuate dhe nuk ndërhyjnë më tepër se që është e nevojshme në punën normale të institucioneve të arsimit të lartë.

2.3 Kriteret për vendimmarrje

Standardi:

Çdo vendim formal i marrë si rezultat i një aktiviteti të kontrollit të jashtëm të cilësisë duhet të bazohet në kriteret të qarta dhe të publikuara që aplikohen me konsistencë..

Udhëzimet:

Vendimet formale të agjencive për sigurimin e cilësisë kanë ndikim të madh në institucionin dhe në programet për të cilat gjykohet. Në interes të barazisë dhe besueshmërisë, vendimet duhet të mbështeten në kriteret të publikuara që interpretohen me konsistencë. Përfundimet duhet të bazohen në të dhëna të regjistruara dhe agjencitë duhet të kenë mënyra për t'i formuluar përfundimet me maturi po qe nevoja.

2.4 Proceset në pajtim me qëllimin e tyre

Standardi:

Të gjitha proceset për sigurimin e jashtëm të cilësisë duhet të disenjohen ashtu që t'i përgjigjen qëllimit dhe objektivave të përcaktuara për to.

Udhëzimet:

Agjencitë për sigurimin e cilësisë brenda HEAL përdorin procese të ndryshme të vlerësimit të jashtëm për qëllime të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme. Mbi të gjitha është me rëndësi që agjencitë të përdorin procedura që i përgjigjen qëllimeve të tyre të definuara dhe të publikuara. Sidoqoftë, përvoja ka treguar se janë në përdorim të gjerë ca elemente të proceseve të vlerësimit të jashtë që flasin, jo vetëm për vlerën, besueshmërinë dhe dobinë e tyre, por edhe ofrojnë një bazë për dimensionin evropian të sigurimit të cilësisë. Disa prej tyre vlen të përmenden në veçanti:

- insistimi që ekspertët që ndërmarrin aktivitete të sigurimit të jashtëm të cilësisë të kenë shkathtësi adekuate;
- kujdesi në procesin e zgjedhjes së ekspertëve;

- sigurimi i informimit ose trajnimit adekuat për ekspertë;
- përdorimi i ekspertëve ndërkombëtarë;
- pjesëmarrja e studentëve;
- sigurimi se procedurat e vlerësimit janë të mjaftueshme për të ofruar fakte që mbështesin konstatimet dhe përfundimet;
- përdorimi i modeleve të vlerësimit që bazohen në vetëvlerësim/vizita në terren/draft raporte/raporte të publikuara/aktivitete përcjellëse;
- njohja e rëndësisë së politikave institucionale për përmirësim dhe zhvillim si element fundamental në sigurimin e cilësisë.

2.5 Raportimi

Standardi:

Raportet duhet të publikohen dhe të jenë të shkruara me një gjuhë të qartë dhe adekuate për publikun që i dedikohen. Çdo vendim, lëvdatë apo rekomandim duhet të gjendet lehtë nga lexuesi.

Udhëzimet:

Për të arritur dobi maksimale nga proceset e sigurimit të jashtë të cilësisë, është me rëndësi që raportet të jenë në pajtim me nevojat e identifikuar të lexuesve të synuar. Ndonjëherë, raportet i dedikohen kategorive të ndryshme të lexuesve dhe kërkojnë vëmendje karshi strukturës, stilit dhe tonit.

Në përgjithësi, raportet duhet të strukturohen ashtu që mbulojnë përshkrimin, analizën (përfshirë faktet relevante), përfundimet, lëvdatat dhe rekomandimet. Duhet të ketë shpjegime të mjaftueshme preliminare që i bëjnë të mundur lexuesit të painformuar ta kuptojë qëllimin e vlerësimit, formën e tij dhe kriteret që janë përdorur për vendimmarrje. Konstatimet kryesore, përfundimet dhe rekomandimet duhet të gjinden lehtë nga lexuesi.

Raportet duhet të publikohen në format të përshtatshëm, ndërsa lexuesve dhe shfrytëzuesve të raporteve (brenda institucioneve relevante dhe jashtë tyre) duhet ofruar mundësinë të bëjnë komente për dobinë e tyre.

2.6 Procedurat për veprim të mëtutjeshëm

Standardi:

Proceset për sigurimin e cilësisë që përmbajnë rekomandime për veprim ose që kërkojnë plane veprimi duhet të kenë procedura të paracaktuara për veprim të mëtutjeshëm që zbatohen me konsistencë.

Udhëzimet:

Sigurimi i cilësisë nuk është proces i shikimit të kujdesshëm nga individi, por duhet të synojë që puna të kryhet sa më mirë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë nuk merr fund me publikimin e raportit, por duhet të ketë procedura të strukturuar për veprim të mëtutjeshëm për të siguruar se rekomandimet respektohen, ndërsa planet e kërkuara për veprim hartohen dhe zbatohen. Kjo mund të kërkojë takime të reja me përfaqësuesit e institucioneve ose programeve që vlerësohen. Objektiva është të sigurohet se në fushat e identifikuara për përmirësim po punohet me shpejtësi dhe se inkurajohet përmirësimi i mëtutjeshëm.

2.7 Vlerësimet periodike**Standardi:**

Sigurimi i jashtëm i cilësisë së institucioneve dhe/ose programeve duhet të ndërmerret në mënyrë ciklike. Kohëzgjatja e ciklit dhe e procedurave të vlerësimit duhet të jetë qartë e definuar dhe të publikohet paraprakisht.

Udhëzimet:

Sigurimi i cilësisë nuk është proces statik, por dinamik. Ai duhet të jetë i vazhdueshëm dhe jo “vetëm një herë gjatë jetës”. Ky proces nuk përfundon me vlerësimin e parë ose me përfundimin e procedurave formale për veprim të mëtutjeshëm. Ai duhet të përsëritet periodikisht. Rishikimet pasuese duhet të marrin parasysh progresin nga vlerësimi i kaluar. Proceset që përdoren duhet të jenë qartë të definuara nga agjencia për kontrollin e jashtëm të cilësisë, ndërsa kërkesat e saj ndaj institucioneve nuk duhet të tejkalojnë masën e nevojshme për arritjen e objektivave të saj.

2.8 Analizat gjithëpërfshirëse të sistemit**Standardi:**

Kohë pas kohe, agjencitë për sigurimin e cilësisë duhet të hartojnë raporte përmbledhëse që shpjegojnë dhe analizojnë konstatimet e përgjithshme të vlerësimeve të tyre.

Udhëzimet:

Të gjitha agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë mbledhin informata të shumta për programe dhe/ose institucione individuale, gjë që ofron material për analiza të strukturuar të sistemeve të arsimit të lartë. Këto analiza mund të ofrojnë informacion shumë të dobishëm për zhvillimet, trendet, praktikat e mira që paraqiten dhe fushat ku vazhdimisht ka vështirësi dhe dobësi, si dhe mund të bëhen vegël e dobishme për zhvillimin e politikave dhe ngritjen e cilësisë. Agjencitë duhet të shqyrtojnë mundësinë që të ushtrorjnë edhe rol hulumtues dhe zhvillimor për të nxjerrë përfitim maksimal nga puna e tyre.

Hyrje në pjesën e tretë: Standardet evropiane dhe udhëzimet për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë

Zhvillimi i agjencive evropiane për sigurimin e jashtëm të cilësisë ka qenë i hovshëm që nga fillimi i viteve të 1990-ta. Në kohë të njëjtë, bashkëpunimi dhe këmbimi i përvojave në mes të agjencive ka qenë element përbërës i këtij zhvillimi. Që në vitin 1994/95, i ashtuquajtur, Projekti Pilot Evropian i iniciuar nga Komisioni Evropian ka rezultuar me njohjen e ndërsjellë të metodologjive themelore për sigurimin e cilësisë nga ana e agjencive: agjenci të pavarura, vetëvlerësimi, vizitat e jashtme në terren dhe raportimi publik, të cilat janë përfshirë në Rekomandimin e Këshillit të BE të vitit 1999 për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Prandaj, themelimi i ENQA në vitin 2000 ishte një formalizim natyral i zhvillimit të bashkëpunimit dhe ENQA ka arritur të punojë në bazë të konsensusit fillestar të arritur në vitet 1990-ta.

Standardet evropiane për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë që janë dhënë në vijim janë zhvilluar mbi supozimin e këtij zhvillimi në historinë e re të sigurimit të jashtëm të cilësisë në Evropë. Për më tepër, me vetëdije është tentuar që standardet të mos jenë shumë të detajuara, as shumë preskriptive. Ato nuk duhet të kufizojnë lirinë e agjencive për sigurimin e cilësisë në Evropë për të reflektuar për organizimin, proceset, përvojat dhe pritshmëritë e kombit ose rajonit që shërbejnë. Megjithatë, standardet duhet të sigurojnë që profesionalizmi, besueshmëria dhe integriteti i agjencive të jetë i dukshëm dhe transparent për palët me interes, si dhe duhet të jenë të krahasueshme dhe të vëzhgueshme nga agjencitë e tjera, duke lënë hapësirë për dimensionin evropian.

Duhet shtuar se, në këtë mënyrë, standardet, po ashtu, i kontribuojnë natyrshëm punës që po bëhet drejt arritjes së njohjes së ndërsjellë të agjencive dhe të rezultateve të vlerësimeve dhe të akreditimeve të tyre. Kjo çështje është analizuar në kuadër të Rrjetit Nordik për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (NOQA) dhe është pjesë e “Kodit të praktikave të mira” të Konsorciumi Evropian për Akreditime (ECA).

Janë dhënë disa “udhëzime” për të ofruar informacion shtesë për praktikën e mira dhe, në disa raste, për të përshkruar me më shumë hollësi kuptimin dhe rëndësinë e standardeve. Edhe pse udhëzimet nuk janë pjesë e vet standardeve, standardet duhet të shihen në kombinim me to.

Pjesa e tretë: Standardet evropiane për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë

3.1 Përdorimi i procedurave për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë

Standardi:

Agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë duhet të marrin parasysh praninë dhe efektivitetin e proceseve të jashtme

për sigurimin e cilësisë, të dhëna në pjesën e dytë të Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane.

Udhëzimet:

Standardet për sigurimin e jashtëm të cilësisë, të dhëna në pjesën e dytë, ofrojnë bazë të mirë për procesin e jashtëm të sigurimit të cilësisë. Standardet reflektojnë praktikën dhe përvojat më të mira të fituara përmes zhvillimit të sigurimit të jashtëm të cilësisë që nga fillimi i viteve të 1990-ta. Prandaj është me rëndësi që këto standarde të integrohen në procese që aplikojnë agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë në institucione të arsimit të lartë.

Standardet për sigurimin e jashtëm të cilësisë, bashkë me standardet për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë paraqesin bazë për një sigurim të jashtëm të cilësisë në institucione të arsimit të lartë, profesional dhe të besueshëm.

3.2 Statusi zyrtar

Standardi:

Agjencitë duhet të jenë formalisht të njohura nga autoritetet publike kompetente në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë si agjenci me përgjegjësi për sigurimin e jashtëm të cilësisë dhe duhet të kenë bazë ligjore. Ato duhet të punojnë në pajtim me kërkesat e legjislacionit brenda të cilit veprojnë.

3.3 Aktivitetet

Standardi:

Agjencitë duhet të ndërmarrin me rregull aktivitete për sigurimin e jashtëm të cilësisë (në nivel të institucionit ose të programit).

Udhëzimet:

Kjo mund të nënkuptojë vlerësimin, rishikimin, auditimin, analizën, akreditimin dhe aktivitete të ngjashme që duhet të jenë pjesë e funksionit bazë të agjencisë.

3.4 Burimet

Standardi:

Agjencitë duhet të kenë burime adekuate dhe proporcionale, si njerëzore ashtu edhe financiare, për të qenë e mundur të organizojnë dhe të zbatojnë proceset e jashtme për sigurimin e cilësisë në mënyrë efektive dhe efikase, në masë të mjaftueshme për zhvillimin e proceseve dhe procedurave të tyre.

3.5 Deklarata e misionit

Standardi:

Agjencitë duhet të kenë qëllime dhe objektiva të qarta për punën e tyre, të përfshira në deklaratën e bërë publike.

Udhëzimet:

Këto deklaratat duhet të përshkruajnë qëllimet dhe objektivat e proceseve për sigurimin e cilësisë të agjencive, ndarjen e detyrave me palët me interes në arsimin e lartë, në veçanti me institucionet e arsimit të lartë, si dhe konteksti kulturor dhe historik të punës së tyre. Deklaratat duhet të bëjnë të qartë se proceset për sigurimin e jashtëm të cilësisë paraqesin aktivitet qendror të agjencisë dhe se ekziston qasja sistematike për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të saj. Po ashtu, duhet të ekzistojë dokumentacioni që demonstro se si këto deklaratat përkthehen në politikë të qartë dhe në plan menaxhimi.

3.6 Pavarësia

Standardi:

Agjencitë duhet të jenë të pavarura duhet të jenë të pavarura deri në masën që të kenë përgjegjësi autonome për veprimet e tyre, si dhe që përfundimet dhe rekomandimet në raportet e tyre të mos mund të ndikohen nga palët e treta siç janë: institucionet e arsimit të lartë, ministritë ose palët e tjera me interes.

Udhëzimet:

Një agjenci duhet të demonstrojë pavarësinë e vet përmes masave si:

- Pavarësia operative e saj nga institucionet e arsimit të lartë dhe qeveritë garantohehet në dokumente zyrtare (p.sh. instrumentet e qeverisjes, ose aktet legjislative).
- Definimi dhe zbatimi i procedurave dhe metodave, nominimi dhe emërimi i ekspertëve të jashtëm dhe përcaktimi i rezultateve të proceseve për sigurimin e cilësisë duhet të bëhet në mënyrë autonome dhe pavarësisht nga qeveritë, institucionet e arsimit të lartë dhe organet me ndikim politik.
- Derisa palët relevante me interes në arsimin e lartë, në veçanti studentët duhet të konsultohen si pjesë e proceseve për sigurimin e cilësisë, rezultati përfundimtar i proceseve për sigurimin e cilësisë mbetet përgjegjësi e agjencisë.

3.7 Kriteret dhe proceset për sigurimin e jashtëm të cilësisë që përdoren nga agjencitë

Standardi:

Procesi, kriteret dhe procedurat që përdoren nga agjencitë duhet të jenë të parafinuara dhe të bëra publike. Normalisht, pritet që këto procese të përfshijnë:

- procedura për vetëvlerësim ose procedura ekuivalente nga subjekti i procesit për sigurimin e cilësisë;
- vlerësimin e jashtëm nga një grup ekspertësh që përfshin, nëse është e përshtatshme, (a) anëtarë studentë dhe (b) vizita në terren sipas vendimit të agjencisë;
- publikimi i raportit, përfshirë çfarëdo vendimi, rekomandimi ose rezultate formale;
- procedurë për veprim të mëtutjeshëm për vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga subjekti i procesit për sigurimin e cilësisë në dritën e rekomandimeve të dhëna në raport.

Udhëzimet:

Agjencitë mund të zhvillojnë dhe shfrytëzojnë edhe procese dhe procedura të reja për qëllime të caktuara.

Agjencitë duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë dhe gjatë gjithë kohës parimeve të deklaruara, si dhe të sigurojnë se kërkesat dhe proceset e tyre menaxhohen me profesionalizëm dhe se përfundimet dhe vendimet e tyre arrihen në mënyrë konsistente, edhe pse vendimet merren nga grupe të ndryshme njerëzish.

Agjencitë që marrin vendime formale për sigurimin e cilësisë, ose nxjerrin përfundime me pasoja, duhet të kenë procedura të ankesës. Natyra dhe forma e procedurave të ankesës duhet të përcaktohet me statutin e çdo agjencie.

3.8 Procedurat e llogaridhënies

Standardi:

Agjencitë duhet të kenë procedura për llogaridhënien e tyre.

Udhëzimet:

Këto procedura duhet të përfshijnë elementet vijuese:

1. Një politikë të publikuar për sigurimin e cilësisë të vet agjencisë, të bërë publike në ueb sajtin e saj.
2. Dokumentacionin që demonstroi se:
 - proceset dhe rezultatet e agjencisë reflektojnë misionin e saj dhe qëllimet e sigurimit të cilësisë;
 - agjencia ka dhe zbaton mekanizma për pengimin e konfliktit të interesit të ekspertëve të saj të jashtëm;
 - agjencia ka mekanizma të besueshëm që sigurojnë cilësinë e aktiviteteve të saj dhe të materialeve të subkontraktuesve, nëse disa ose të gjitha elementet në procedurat e saj sigurimin e cilësisë i janë subkontraktuar palëve të tjera;
 - agjencia ka procedura për sigurimin e brendshëm të cilësisë që përfshijnë një mekanizëm të brendshëm për

informata kthyese (p.sh. mbledhja e informatave kthyese nga personeli dhe këshilli/bordi); mekanizëm të brendshëm reflektimi (p.sh. reagim ndaj rekomandimeve të brendshme dhe të jashtme për përmirësim); dhe mekanizëm për mbledhjen e informatave kthyese nga jashtë (p.sh. mbledhja e informatës kthyese nga ekspertët dhe institucionet e vlerësuara për zhvillim të mëtutjeshëm) me qëllim të informimit dhe mbështetjes së zhvillimit dhe përmirësimit vetanake.

3. Vlerësimin e jashtëm të obligueshëm të aktiviteteve të agjencisë të paktën një herë në pesë vjet.

3 Sistemi i vlerësimit profesional për agjencitë për sigurimin e cilësisë

Në Berlin ministrat e ftuan “ENQA-n që, përmes anëtarëve të saj, e në bashkëpunim me EUA, EURASHE dhe ESIB, të ... shqyrtojë rrugë për sigurimin e sisteme adekuate të vlerësimit profesional për agjencitë ose trupat për sigurimin e cilësisë/akreditim”.

ENQA dhe partnerët e saj iu përgjigjën kësaj ftese duke interpretuar mandatin e dhënë se sistemi i vlerësimit profesional për agjencitë duhet të përfshijë, jo vetëm vet procesin e vlerësimit profesional, por edhe shqyrtimin me kujdes të standardeve të cilësisë për bërjen e vlerësimit. Më tutje, është arritur deri te një marrëveshje se vlerësimi profesional i agjencive duhet interpretuar si mënyrë për arritjen e qëllimit të transparencës, njohjes nga publiku dhe krahasueshmërisë së cilësisë së agjencive.

Prandaj, ky raport përmban një propozim me rëndësi për krijimin e një regjistri të agjencive të njohura për sigurimin e cilësisë që veprojnë në arsimin e lartë në Evropë. Ky propozim paraqet një përgjigje ndaj pritshmërive që, së shpejti, të ketë rritje të numrit të trupave të interesuar për të nxjerrë përfitime nga vlera e titulli i institucionit të pranuar ose të akredituar. Përvoja e të tjerëve ka treguar se është vështirë të kontrollohen këto ndërmarrje, por Evropa ka një mundësi unike që të menaxhojë praktikisht këtë treg të ri, jo për t'i mbrojtur interesat e agjencive tanimë të themeluara, por për t'u siguruar se përfitimet nga siguri i cilësisë nuk rrezikohen nga njerëz me vlera të dyshimta.

Puna në këto propozime ka marrë parasysh kontekstin evropian dhe kërkesat. Në të njëjtën kohë, gjatë këtij procesi është kuptuar se përvoja dhe procese të ngjashme po zhvillohen në rrafshin ndërkombëtar. Prandaj, ky kapitull fillon me një analizë të shkurtër të përvojave dhe të nismave ndërkombëtare relevante për hartimin e këtij raporti. Pastaj, përshkruhet sistemi i propozuar i vlerësimit profesional që bazohet në parimin e subordinimit të Standardeve evropiane për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë. Ky përshkrim çon në prezantimin e regjistrit të rekomanduar për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë që veprojnë në Evropë. Vlerësimet profesionale dhe respektimi i standardeve evropiane nga agjencitë kanë rol qendror në përpilimin e regjistrit. Përfundimisht, është propozuar Forumi Konsultativ Evropian për Sigurimin e

Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Konteksti ndërkombëtar

Evropa nuk është zona e vetme me zhvillime dinamike në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Këtu shpjegohen disa përvoja dhe nisma të organizatave si Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (INQAAHE), Rrjeti Ndërkombëtar i Rektorëve të Universiteteve (IAUP), Këshilli për Akreditime në Arsimin e Lartë i Shteteve të Bashkuara (CHEA), OECD dhe UNESCO. Puna e këtyre organizatave në fushën e sigurimit të cilësisë është treguar mjaft e dobishme gjatë hartimit të këtij raporti. Edhe pse këto përvoja ndërkombëtare nuk janë përfshirë në mënyre të drejtpërdrejtë në rekomandimet specifike, disa elemente kyçe ndërkombëtare janë prezantuar më poshtë në ndërlidhje me rekomandimet e këtij kapitulli.

Identifikimi i cilësisë së mirë dhe të praktikave të mira të agjencive për sigurimin e jashtëm të cilësisë ka qenë në agjendën ndërkombëtare për disa vite me radhë. Që nga viti 1999 INQAAHE ka diskutuar për ndarjen e titujve agjencive për sigurimin e jashtëm të cilësisë, një ide që fillimisht është iniciuar nga IAUP për t'i plotësuar nevojat e institucioneve të arsimit të lartë për identifikimin e agjencive të kualifikuara për të kryer rolin e sigurimit të jashtëm të cilësisë. Ideja për titullin e cilësisë hasi në rezistencë të përgjithshme, prandaj INQAAHE u përqendrua në formulimin e kriterëve të praktikave të mira për agjenci. Rezultat i kësaj janë parimet që paraqesin emëruesin e përbashkët të praktikave të mira, duke njohur njëkohësisht diversitetin ndërkombëtar të agjencive në kuptimin e qëllimit dhe kontekstit historik-kulturor.

Në kuptim të rekomandimeve për vlerësimin profesional të agjencive, është relevante puna që ka bërë CHEA. Kjo është një organizatë joqeveritare që funksionon si ombrellë për agjencitë e akreditimit në SHBA, qofshin ato rajonale, të specializuara, nacionale apo profesionale. Organizatat akredituese që kërkojnë njohje nga CHEA duhet të demonstrojnë se i plotësojnë standardet e njohjes të CHEA. Nga organizatat akredituese kërkohet që të avancojnë cilësinë akademike, të demonstrojnë llogaridhënie, të inkurajojnë përmirësimin, të përdorin procedura adekuate, t'i rishqyrtojnë në vazhdimësi praktikat e akreditimit dhe të posedojnë burime të mjaftueshme. CHEA kërkon nga të gjithë anëtarët që të kalojnë nëpër procedurën e vlerësimit me qëllim të njohjes çdo gjashtë vjet. Ka ngjashmëri dhe kompatibilitet në mes të qasjes së CHEA dhe propozimeve të këtij raporti, p.sh. në kuptimin e rishikimeve (vlerësimeve) ciklike. Sidoqoftë, ky raport i jep përparësi përqendrimit të artë në sigurimin e cilësisë së agjencive.

Një nismë tjetër është ndërmarrë nga OECD dhe UNESCO për të elaboruar udhëzimet për sigurim të cilësisë në arsimin e lartë ndërkombëtar. Udhëzimet e OECD-UNESCO-s do të përfundojnë në vitin 2005, por procesi i hartimit të tyre ka zbuluar kontrastin në mes të nevojës për të rregulluar ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë dhe faktit se kapacitetet ekzistuese nacionale të sigurimit të cilësisë, shpesh, fokusohen vetëm në shërbimet vendore të institucionit vendor. Prandaj, është një sfidë për sistemet ekzistuese të sigurimit të cilësisë të zhvillohen metodologji dhe mekanizma përkatës që, përveç institucioneve dhe programeve vendore, mbulojnë edhe institucione dhe programe të huaja me qëllim të maksimizimit të përfitimeve dhe kufizimit të disavantazheve të mundshme të ndërkombëtarizimit

të arsimit të lartë.

Udhëzimet e propozuara të OECD-UNESCO-s rekomandojnë që agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë të të bëjnë të mundur që sigurimi i cilësisë të përfshinë edhe institucionet e huaja dhe ato për përfitim, si dhe mësimin në distancë dhe format tjera jotradicionale të arsimit. Sidoqoftë, është e qartë për hartuesit e udhëzimeve se përfshirja e institucioneve të huaja në fushëveprimin e agjencive kombëtare, në të shumtën e rasteve, do të kërkojë ndryshim të legjislacionit kombëtar dhe të procedurave.

Ky raport merr parasysh rëndësinë dhe pasojat e ndërkombëtarizimit për sigurimin e cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë. Edhe pse është konsideruar e parakohshme që Standardet evropiane për sigurimin e cilësisë të përmbajnë referenca të tilla, propozimi për Regjistrin Evropian i për Regjistrin Evropian i përfshin, në mënyrë të qartë, agjencitë jashtë Evropës që punojnë këtu, si dhe agjencitë evropiane që veprojnë jashtë Evropës.

Gjithashtu, duhet konstatuar se procesi Evropian në vazhdimësi e respekton në tërësi rekomandimin e OECD-UNESCO-s se agjencitë duhet t'i mbajnë dhe t'i forcojnë rrjetet ekzistuese rajonale dhe ndërkombëtare.

Vlerësimet ciklike të agjencive

Fusha e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së arsimit të lartë në Evropë është relativisht e ri. Sidoqoftë, mund të quhet si element i pjekurisë së shtuar të agjencive fakti se, vitet e fundit, kanë treguar se ekziston interesimi për të shtuar besueshmërinë e punës së agjencive duke u përqendruar në sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së punës së vet agjencive. Punëtorja e ENQA, e mbajtur në shkurtin e vitit 2003 në Sitges të Spanjës, ka pasur temë sigurimin e cilësisë së punës të agjencive. Pjesëmarrësit kanë diskutuar për përvojat ekzistuese të vlerësimit të jashtëm të agjencive për vlerësimin e jashtëm të cilësisë dhe një përfundim i punëtorisë ka qenë rekomandimi se ENQA duhet të punojë për të bërë vlerësimin e jashtëm të agjencive anëtare në mënyrë ciklike. Në pajtim me këtë, ENQA ka fituar në Berlin mandatin në kohën kur debati për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, tanimë, kishte filluar në ENQA dhe kishte qenë temë e takimeve të E4.

Ky raport rekomandon se çdo agjenci evropiane, brenda harkut kohor jo më të gjatë se pesë vjet, duhet ta bëjë ose t'i nënshtrohet një vlerësimi të jashtëm ciklik të proceseve dhe të aktiviteteve të saj. Rezultatet duhet të dokumentohen në një raport që tregon deri në ç' masë agjencia respekton standardet evropiane për sigurimin e jashtëm të cilësisë (shih kapitulli 2, pjesa e tretë).

Harta e institucioneve që merren me sigurimin e jashtëm të cilësisë në HEAL, pa dyshim, do të jetë më komplekse në të ardhmen. Prandaj, është me rëndësi që edhe joanëtarët e ENQA të përfshihen në shqyrtime për sigurimin e cilësisë. Është edhe më me rëndësi që për agjencitë joevropiane të jetë e hapur mundësia për vlerësimin vetanak të funksionimit të tyre në raport me standardet evropiane. Prandaj, raporti nuk dëshiron t'i kufizojë rekomandimet e veta vetëm tek agjencitë evropiane të njohura, pikërisht tek anëtarët e tanishëm dhe të mundshëm të ENQA. Përkundrazi, agjencitë joevropiane që veprojnë në Evropë, ose agjencitë evropiane që nuk njihen në nivelin kombëtar, duhet të lejohen të

paraqiten për vlerësim që analizon respektimin e standardeve evropiane nga ana e tyre.

Parimet e përgjithshme për vlerësime ciklike janë propozuar si në vijim:

- Agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë të themeluara dhe të njohura zyrtarisht si agjenci kombëtare nga vendet nënshkruese të Kartës së Bolonjës duhet të vlerësohen në nivel kombëtar duke respektuar parimin e subordinimit edhe atëherë kur veprojnë jashtë kufijve kombëtarë. Nga ana tjetër, këto agjenci kombëtare evropiane mund të kërkojnë vlerësim të organizuar nga ENQA në vend të vlerësimit kombëtar. Vlerësimit e agjencive duhet të analizojnë respektimin e standardeve evropiane për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë.
- Agjencitë që nuk janë themeluar dhe nuk njihen zyrtarisht në vendet nënshkruese të Kartës së Bolonjës mund të kërkojnë vlerësim në raport me standardet evropiane agjenci për sigurimin e jashtëm të cilësisë.
- Procesi i vlerësimit duhet të përfshijë vetëvlerësimin, panelin e pavarur të ekspertëve dhe raportin e publikuar.

Nisma për vlerësimin e jashtëm, si rregull, vjen nga niveli kombëtar ose i agjencisë. Prandaj, pritet që vlerësimet e agjencive të parashihen me rregullat në nivel kombëtar ose me proceset për sigurimin e brendshëm të vet agjencie. Ky raport dëshiron të theksojë parimin e subordinimit, prandaj propozohet që ENQA të marrë nismën për vlerësimin e jashtëm të anëtarit të saj vetëm nëse, pas pesë vitesh, nuk është marrë asnjë nismë në nivelin kombëtar ose nga vet agjencia. Nëse agjencia nuk është anëtare e ENQA dhe, pas pesë vitesh, nuk ka iniciativë për vlerësim të jashtëm në nivel kombëtar ose nga vet agjencia, Komiteti i Regjistrimit Evropian është përgjegjës për të iniciuar vlerësimin.

Kur autoritetet kombëtare iniciojnë vlerësimin, qëllimi i tij mund të jetë mjaft i gjerë, duke përfshirë edhe përmbushjen e mandatit kombëtar nga agjencia. Megjithatë, element kyç i këtij propozimi është se, pa marrë parasysh kush ka iniciuar vlerësimin- niveli kombëtar, agjencia apo ENQA, gjithnjë duhet të analizohet në ç' masë agjencia përmbushë standardet evropiane për agjenci për sigurimin e jashtëm të cilësisë. Në pajtim me këtë, vlerësimi i një agjencie nuk jep të dhëna vetëm për nivelin e përmbushjes së standardeve evropiane, por flet edhe për shkallën e përmbushjes së kriterëve për anëtarësi në ENQA.

Më në fund, raporti thekson se përfshirja e ekspertëve ndërkombarë me ekspertizë dhe përvojë adekuate e shton dukshëm vlerën e procesit të vlerësimit.

Marrja e veprimeve të mëtutjeshme pas vlerësimit ciklik është, para se të gjithash, obligim i autoriteteve kombëtare dhe pronarëve të agjencisë dhe, kuptohet, i vet agjencisë. ENQA do të ketë rol në veprimet e mëtutjeshme vetëm në rastin e agjencive anëtare ku ENQA, në bazë të vlerësimit, duhet të certifikojë shkallën e përmbushjes së standardeve evropiane për sigurimin e jashtëm të cilësisë nga agjencia anëtare. Rregulloret e ENQA do të përcaktojnë pasojat për rastet e mospërmbushjes.

Një përshkrim ilustrativ i një shembulli të procesit për vlerësimin e jashtëm të agjencisë është dhënë në shtojcën e këtij raporti.

Regjistri i agjencive për sigurimin e jashtëm të cilësisë që veprojnë në Evropë

Para Konferencës së Ministrave në Berlin (2003), ENQA ka deklaruar përkushtimin e vet që, në bashkëpunim me palët me interes, të zhvillojë Regjistrin Evropian të Agjencive për Sigurimin e Cilësisë që përfshinë agjencitë publike, private dhe tematike që veprojnë ose planifikojnë të veprojnë në Kosovë.

Regjistri do të ishte në pajtim me interesat e institucioneve të arsimit të lartë dhe të qeverive që të identifikojnë agjenci profesionale dhe të besueshme për sigurimin e cilësisë që veprojnë në Evropë. Ky interes ka bazë në fushën e ndërlikuar të njohjes së thirrjeve nga vendet tjera. Procedurat e njohjes do të përforcohen nëse bëhet transparente deri në ç' masë agjencitë e njohura sigurojnë cilësinë e institucioneve të arsimit të lartë. E dyta, po bëhet e mundur për institucionet e arsimit të lartë të kërkojnë sigurim të cilësisë nga agjencitë jashtë kufijve kombëtare. Regjistri i besueshëm i ndihmon institucionet e arsimit të lartë të identifikojnë agjenci profesionale.

Pra, përparësia e regjistrit qëndron në vlerën informative për institucionet dhe palët tjera me interes, ndërsa vet regjistri mund të shndërrohet në instrument të dobishëm për të arritur transparencë dhe krahasueshmëri të sigurimit të jashtëm të cilësisë të institucioneve të arsimit të lartë.

Regjistri duhet të tregojë në ç' masë agjencitë e regjistruara i përmbushin standardet evropiane për agjenci për sigurimin e jashtëm të cilësisë. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se ky raport nuk propozon që regjistri të jetë instrument për rangim.

Regjistri duhet të jetë i hapur për aplikimin e të gjitha agjencive që ofrojnë shërbime brenda Evropës, përfshirë ato veprojnë nga vendet joevropiane, si dhe ato me bazë transnacionale ose ndërkombëtare. Këto agjenci do të evidentohen në ndarje të ndryshme të regjistrit në varësi nga fakti a është bërë apo jo vlerësimi profesional i tyre, a i përmbushin apo jo standardet evropiane për agjenci për sigurimin e jashtëm të cilësisë, dhe a funksionojnë vetëm brenda apo edhe jashtë kufijve kombëtarë.

Me poshtë është prezantuar struktura e mundshme e regjistrit:

Ndarja 1. Agjencitë për të cilat është bërë vlerësimi profesional të ndara në kategoritë vijuese:

- Agjencitë kombëtare evropiane që janë vlerësuar profesionalisht dhe plotësojnë standardet evropiane për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë.
- Agjencitë kombëtare evropiane që janë vlerësuar profesionalisht, por nuk i plotësojnë standardet evropiane për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë.
- Agjencitë jokombëtare dhe joevropiane që veprojnë në Evropë, janë vlerësuar profesionalisht dhe plotësojnë standardet evropiane për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë.
- Agjencitë jokombëtare dhe joevropiane që veprojnë në Evropë, janë vlerësuar profesionalisht, por nuk i plotësojnë standardet evropiane për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë.

Ndarja 2. Agjencitë që nuk janë vlerësuar profesionalisht :

- Agjencitë kombëtare, jokombëtare dhe joevropiane për të cilat nuk është bërë vlerësimi profesional, prandaj janë përfshirë në regjistër në bazë të informatave të ofruara në aplikimet e tyre.

E prezantuar në formë tabelare, struktura e Regjistrit duket si vijon:

| Struktura e propozuar e regjistrit | | Të vlerësuara profesionalisht | | Nuk janë vlerësuar profesionalisht |
|---|--------------------------|---------------------------------|-------------------------------------|------------------------------------|
| | | Përmbushin standardet evropiane | Nuk përmbushin standardet evropiane | |
| Agjenci kombëtare evropiane | Brenda kufijve kombëtarë | | | |
| | Jashtë kufijve kombëtarë | | | |
| Agjenci jokombëtare evropiane | | | | |
| Agjenci joevropiane që veprojnë në Evropë | | | | |

Komiteti i Regjistrit Evropian merr vendim për shënimin në Regjistrin Evropian. Komiteti do të shfrytëzojë përmbushjen standardeve evropiane për agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë, të definuar gjatë vlerësimit ciklik, si një kriter për klasifikim në regjistër. Duhet të zhvillohen edhe kritere të tjera që marrin parasysh diversitetin e sistemeve të arsimit të lartë.

Komiteti do të jetë një strukturë joburokratike me nëntë anëtarë të nominuar nga EURASHE, ESIB, EUA, ENQA dhe organizatat që përfaqësojnë punëdhënësit evropianë, sindikatat dhe organizatat profesionale, si dhe përfaqësues të qeverive. Këta anëtarë do të veprojnë si individë, e jo si përfaqësues të mandatuar të organizatave që i kanë nominuar. ENQA do t'i kryej detyrat e sekretarisë për Komitetin që do të takohet të paktën një herë në gjashtë muaj.

Një ndër detyrat e para të Komitetit do të jetë formalizimi i pronësisë së regjistrit.

Një detyrë tjetër për Komitetin e Regjistrit Evropian do të jetë krijimi i një sistemi të pavarur dhe të besueshëm të ankesës për të siguruar të drejtën e atyre që janë refuzuar ose janë të pakënaqur me kategorizimin në regjistër. Ky sistem i ankesave duhet të jetë element në protokollin e hartuar nga Komiteti menjëherë pas fillimit të punës së tij.

Forumi Konsultativ Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë

Që nga Takimi i Pragës i vitit 2004, “Grupi E4” i përbërë nga ENQA, EUA, ESIB dhe EURASHE ka mbajtur takime të rregullta për të diskutuar këndvështrimet ndaj Procesit të Bolonjës dhe Cilësisë Evropiane në arsimin e lartë. Që nga Takimi i Berlinit i vitit 2003, takimet e E4 janë përqendruar në mandatin e dhënë nga ministrat për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Ky bashkëpunim në nivel evropian është treguar të jetë konstruktiv. Të katër organizatat janë pajtuar që Forumi Konsultativ Evropian për Arsimin e Lartë të vazhdojë të veprojë në bazë të punës së bërë nga E4. Në praktikë, ky forum do të bazohet në intensifikimin e bashkëpunimit ekzistues të ENQA, EUA, EURASHE dhe ESIB. Forumi do të funksiononte si trup konsultativ dhe këshillëdhënës për palët me interes në Evropë dhe me organizim të ngjashëm si deri tani, ku të katër organizatat do të financonin shpenzimet e veta dhe pjesëmarrjen pa krijuar struktura të reja administrative. Në afat më të gjatë, forumi duhet t'i përfshijë edhe përfaqësuesit e tregut të punës.

4 Perspektivat dhe sfidat e së ardhmes

Ky raport përmban propozime dhe rekomandime që janë zhvilluar dhe mbështeten nga faktorë kyç evropianë në botën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Vet ekzistimi i këtij raporti paraqet dëshmi se është arritur një këndvështrim i përbashkët në fushën ku një këndvështrim i tillë mund të duket vështirë i arritshëm, duke marrë parasysh interesat e ndryshme që ekzistojnë. Propozimet ofrojnë transparencë të shtuar, siguri dhe informim të studentëve, të shoqërisë dhe më gjerë për arsimin e lartë. Po ashtu, ato i ofrojnë institucioneve të arsimit të lartë njohje dhe besueshmëri, si dhe mundësi për të demonstruar përkushtimin ndaj cilësisë së lartë në një mjedis garues dhe skeptik. Agjencive për sigurimin e cilësisë, propozimet i ofrojnë mundësi për të avancuar cilësinë dhe kredibilitetin e vet dhe i lidhin në mënyrë më produktive me komunitetin profesional në Evropë.

Sidoqoftë, këto propozime nuk do të jenë më shumë se propozime nëse nuk shoqërohen nga një strategji efektive për implementimin e tyre. Nëse aprovohen nga ministrat në Bergen, do të ndërmerren hapa të menjëhershëm për t'i jetësuar disa nga elementet e këtij raporti. Puna në regjistrin e agjencive për sigurimin e cilësisë duhet të fillojë ka fundi i pjesës së dytë të vitit 2005 dhe duhet të vihet në veprim *on-line* në vitin 2006. Vlerësimet e para ciklike duhet të priten gjatë vitit 2005.

Forumit Konsultativ Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, po ashtu, do të jetë një nismë e shpejtë. Prandaj, përfundimet e Takimit Ministror të Bergenit dhe krijimi i këtij forumi do të jenë temat kryesore të takimit të radhës në mes të ENQA dhe partnerëve nga "Grupi E4" në qershorin e vitit 2005. Përveç kësaj, do të diskutohet bashkëpunimi i ardhshëm me palët tjera me interes siç janë përfaqësuesit e tregut të punës. Po ashtu, ENQA ka aranzhuar takim me rrjetet tjera për sigurimin e cilësisë në Evropë që duhet të mbahet para Asamblesë së Përgjithshme të ENQA në shtatorin e vitit 2005.

Mundësia e implementimit të shpejtë të disa propozimeve të këtij raporti nuk duhet të merret si shenjë se jetësimi i propozimeve të tjera do të jetë detyrë e lehtë. Do të marrë shumë kohë që standardet për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë të adoptohen nga institucionet dhe agjencitë, sepse pranimi do të varet nga gatishmëria për të bërë ndryshime në vendet nënshkruese me sisteme stabile dhe të fuqishme të arsimit të lartë. Ajo që propozohet në standardet e brendshme të sigurimit të cilësisë do të jetë sfiduese për disa institucione të arsimit të lartë, në veçanti në

mjediset ku tradita e sigurimit të cilësisë është e re dhe në zhvillim e sipër ose në mjediset ku nevojat e studentëve dhe përgatitja e tyre për të hyrë në tregun e punës nuk është pjesë e kulturës së institucionit. Ngjashëm, standardet për sigurimin e jashtëm të cilësisë dhe për vet agjencitë për sigurimin e cilësisë kërkojnë nga të gjithë pjesëmarrësit, në veçanti agjencitë, të rishikojnë me kujdes punën e vet dhe t'i krahasojnë praktikën e veta me pritshmëritë evropiane. Procedurat e reja të vlerësimit ciklik do të ofrojnë një ndihmë në këtë drejtim. Vetëm atëherë kur përfitimet nga adoptimi i standardeve të shihen mund të pritët aprovimi i përgjithshëm i tyre.

HEAL funksionon në bazë të përgjegjësisë individuale kombëtare për arsimin e lartë, që implikon autonomi në lidhje me sigurimin e jashtëm të cilësisë. Pikërisht për këte arsye, raporti nuk është dhe nuk mund të jetë mekanizëm rregullator, por bën rekomandime dhe propozime në bazë të respektit të ndërsjellë në mes të profesionistëve; ekspertëve nga institucionet e arsimit të lartë përfshirë studentët; ministrive; dhe agjencive për sigurimin e cilësisë. Disa vende nënshkruese mund të për t'i përfshirë standardet dhe proceset e vlerësimit në kornizat e tyre ligjore dhe administrative. Disa të tjera mund të kërkojnë më shumë kohë për të vlerësuar arsyeshmërinë e një veprimi të tillë, duke peshuar përparësitë e ndryshimit në raport me gjendjen e tanishme. Forumi Konsultativ Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, i propozuar në këtë raport, duhet të dëshmojë si vend me dobi për të diskutuar, debatuar dhe mësuar për mënyrën e re të të menduarit, për përvojën e sistemeve të tjera, si dhe për ngjashmëritë dhe dallimet në mes të përvojave kombëtare.

Në përgjithësi, ENQA-n, partnerët nga “Grupi E4” dhe palët kyçe me interes i pret një ngarkesë mjaft e madhe dhe sfida në vitet e ardhshme. Prandaj, raporti e bën të qartë se përfundimi i tij nuk është njëllë sikur të përmbushet objektiva e Bolonjës lidhur me sigurimin e cilësisë. Ka shumë punë në të ardhmen për t'i jetësuar rekomandimet e këtij raporti dhe për të krijuar një kulturë vlerësimi tek institucionet e arsimit të lartë dhe agjencitë për sigurimin e jashtëm të cilësisë. Ajo që është vënë në lëvizje me mandatin e Berlinit do të duhet të mirëmbahet dhe të kultivohet, nëse synohet krijimi i një dimensionit evropian funksional për sigurimin e cilësisë në HEAL.

Tani është e mundur një hapësirë evropiane e arsimit të lartë me institucione të forta, autonome dhe efektive të arsimit të lartë, me një sens të qartë për rëndësinë e cilësisë dhe të standardeve, vlerësime të mira profesionale, agjenci të besueshme për sigurimin e cilësisë, regjistër efektiv dhe bashkëpunim të shtuar me palët e tjera me interes siç janë punëdhënësit, ndërsa propozimet e këtij raporti do të duhet të kalojnë një rrugë të gjatë për ta shndërruar këtë vizion në realitet.

Shtojcë: Vlerësimi ciklik i agjencive për sigurimin e cilësisë⁵ - një model teorik

Modeli i prezantuar më poshtë paraqet një kornizë të mundshme për procesin e vlerësimit të jashtëm të një agjencie për vlerësimin e jashtëm të cilësisë. Ai është prezantuar si shembull i një procesi të besueshëm të përshtatur për të identifikuar pajtueshmërinë me standarde evropiane për agjenci për sigurimin e jashtëm të cilësisë. Sidoqoftë, duhet të merret parasysh se qëllimi është orientues dhe ilustrativ. Për këtë arsye, janë dhënë shumë hollësi, me gjasë më shumë se që janë të nevojshme për një vlerësim profesional individual të agjencive. Nga kjo nënkuptohet se procesi i prezantuar këtu, në asnjë mënyrë, nuk duhet të konsiderohet si standard në vete. Më tutje, duhet të merret parasysh se në shembullin e prezantuar, shprehja “vlerësim” përdoret edhe për objektiva edhe për procese. Po ashtu, do të mund të përdorëshin edhe shprehjet “akreditim” dhe “auditim”.

Elementet përbërëse të procesit janë:

- formulimi i termave të referencës dhe protokollit për vlerësim;
- nominimi dhe emërimi i panelit të ekspertëve;
- vetëvlerësimi i agjencisë;
- vizita në terren;
- raportimi.

1 Termat e referencës

Termat e referencës duhet t'i identifikojnë qëllimet e vlerësimit në kuptim të këndvështrimit dhe interesit të autoriteteve, palëve me interes dhe të vet agjencisë. Duhet të mbulohen detyrat kryesore dhe veprimet e agjencisë në mënyrën që dëshmon se nuk ka asgjë që mbahet e fshehur.

2 Vetëvlerësimi

2.1 Informatat themelore që kërkohen nga agjencia si bazë për vlerësim

Për të kuptuar kontekstin në të cilin vepron agjencia nevojiten disa informata themelore. Kjo ndarje duhet të përmbajë:

⁵ Struktura e kësaj shtojceje është e ngjashme me atë që është prezantuar së voni në një doracak të një projekti për njohjen e ndërsjellë të agjencive për sigurimin e cilësisë në vendet nordike.

2.1.1 Një përshkrim të shkurtër të sistemit kombëtar të arsimit të lartë, përfshirë:

- strukturën e thirrjeve;
- strukturën institucionale;
- procedurat dhe palët e përfshira për zhvillimin e lëndëve, programeve dhe institucioneve të reja;
- procedurat tjera për sigurimin e cilësisë;
- statusi i institucioneve të arsimit të lartë në raport me qeverinë.

2.1.2 Një historik të shkurtër të agjencisë dhe të vlerësimit në arsimin e lartë në përgjithësi:

- deklarata e misionit;
- themelimi i agjencisë (qeveria, institucionet e arsimit të lartë, të tjerët);
- përshkrimi i kornizës ligjore dhe rregullave të tjera formale lidhur me agjencinë (p.sh. ligjet e kuvendit, urdhrat dhe dekretet ministrore);
- financimi i agjencisë;
- e drejta për të iniciuar vlerësime;
- organizimi i brendshëm i agjencisë , përfshirë procedurat për emërimin dhe përbërjen e bordit/këshillit;
- përgjegjësitë e tjera të agjencisë përveç vlerësimit në arsimin e lartë;
- aktivitetet ndërkombëtare të agjencisë përfshirë marrëveshjet formale dhe aktivitetet tjera, p.sh. pjesëmarrja në konferenca, grupe pune dhe këmbimi i personelit;
- roli i agjencisë në veprimet që pasojnë vlerësimin: pasojat dhe sanksionet.

2.2 Sigurimi i jashtëm i cilësisë që ndërmerr agjencia

Duhet të ofrohen prova se agjencia ndërmerr me rregull masa për sigurimin e cilësisë të institucioneve ose të programeve të arsimit të lartë. Këto masa për sigurimin e cilësisë duhet të përfshijnë njërin ose më shumë nga këto veprime: vlerësimin, akreditimin, rishikimin, auditimin ose analizën e gjendjes, dhe përbëjnë funksionin themelor të agjencisë.

“Me rregull” d.m.th. se vlerësimet planifikohen në bazë të procedurave sistematike dhe se disa vlerësime të cilësisë janë bërë në dy vitet e fundit. Provat duhet të përfshijnë:

- një përshkrim të metodologjisë së punës së agjencisë;
- pasqyrën e vlerësimeve të cilësisë që janë bërë dhe të dhëna për numrin e njërive të vlerësuara.

2.3 Metoda e vlerësimit që përdoret nga agjencia

2.3.1 Informata themelore

Përshkrimi i planifikimit të përgjithshëm të një vlerësimi dhe të çështjeve të tjera fundamentale duhet të përcaktojë a punon agjencia me procedura transparente metodologjike. Ky përshkrim duhet të përfshijë:

- procedurat për njoftimin dhe komunikimin me institucionet e vlerësuara;
- strategjinë e agjencisë për pjesëmarrjen e studentëve;
- procedurat për hartimin e termave të referencës/planit të projektit për një vlerësim individual;
- referencat për vlerësim (kriteret e parafinuar, dokumentet ligjore, kriteret e arritshmërisë për lëndë, standardet profesionale, qëllimet e deklaruara të institucionit që vlerësohet);
- shkalla e modifikimit të elementeve metodologjike për vlerësime specifike.

2.3.2 Elemente të metodologjisë

Përshkrimi që dëshmon se metodologjia e agjencisë është e parafinuar dhe publike, si dhe se rezultatet e vlerësimeve janë publike.

Metodologjia përfshinë:

- vetëvlerësimin ose procedura ekuivalente të objektit të vlerësimit;
- vlerësimi i jashtëm nga një grup i ekspertëve dhe vizitat në terren të përcaktuara nga agjencia;
- publikimi i raportit me rezultate publike.

Po ashtu, agjencia mund të zhvillojë dhe të zbatojë metodologji të reja për nevoja të veçanta.

Vendimet dhe raportet e agjencisë janë konsistente në kuptim të parimeve dhe kërkesave, edhe nëse vlerësimi është bërë nga grupe të ndryshme vlerësuese.

Nëse agjencia kryen një vlerësim, ekziston sistemi i ankesave. Kjo metodologji aplikohet në harmoni me nevojat e agjencisë.

Nëse agjencia bën një rekomandim dhe/ose merr vendim me kusht, ajo ka procedura për veprim të mëtutjeshëm për t'i verifikuar rezultatet.

2.3.3 Përshkrimi i rolit të grupit të ekspertëve të jashtëm

Përshkrimi i rolit të grupit të ekspertëve të jashtëm duhet të përfshijë:

- procedurat për nominimin dhe emërimin e ekspertëve, përfshirë kriteret për përdorimin e ekspertëve ndërkombëtarë dhe të përfaqësuesve të palëve me interes siç janë punëdhënësit dhe studentët;

- metodat për informimin dhe trajnimin e ekspertëve;
- takimet ndërmjet ekspertëve: numri, tema dhe orari në raport me procesin e gjithmbarshëm të vlerësimit;
- ndarja e punëve në mes të agjencisë dhe të ekspertëve;
- roli i personelit të agjencisë në vlerësime;
- identifikimi dhe emërimi i personelit të agjencisë përgjegjës për vlerësimin.

2.3.4 Dokumentacioni

Janë të nevojshme disa përshkrime të procedurave të agjencisë për mbledhjen e dokumentacionit për të përcaktuar procedurat e vetëvlerësimit të agjencisë dhe të vizitave në terren:

2.3.4.1 Përshkrimi i procedurave të vetëvlerësimit

Ky përshkrim përfshinë:

- specifikimin e përmbajtjes në udhëzimet e dhëna nga agjencia;
- këshillat procedurale të dhëna nga agjencia;
- kërkesat për formimin e ekipeve për vetëvlerësim, përfshirë rolin e studentëve;
- trajnimi/informimi i ekipeve për vetëvlerësim;
- koha në dispozicion për vetëvlerësim.

2.3.4.2 Përshkrimi i procedurave për vizita terreni

Ky përshkrim përfshinë:

- pyetësorët dhe protokollet e intervistimit;
- parimet për për përzgjedhjen e pjesëmarrësve/informantëve (kategoritë dhe pjesëmarrësit specifikë);
- parimet për kohëzgjatjen e vizitave;
- numri i takimeve dhe kohëzgjatja mesatare;
- dokumentimi i takimeve (të brendshme/të jashtme, procesverbalet, transkriptet, etj.);
- metoda e punës për grupin e ekspertëve të jashtëm.

2.3.4.3 Raportet

Dokumentacioni përmban informatat vijuese për raportet:

- qëllimin e raportit;

- mënyra e hartimit të raportit (personeli i agjencisë ose ekspertët);
- formati i raportit (disenji dhe gjatësia);
- përmbajtja e raportit (dokumentim ose vetëm analiza/rekomandime);
- parimet për informatë kthyesë rreth raportit nga palët e vlerësuara;
- procedurat dhe politikat e publikimit (p.sh. komunikimi me media);
- veprimet e mëtutjeshme të menjëhershme (p.sh. seminarët dhe konferencat);
- veprimet e mëtutjeshme afatgjata (p.sh. vlerësim ose vizitë e mëvonshme).

2.3.5 Sistemi i ankesave

Agjencia dokumenton mënyrën për ushtrimin e ankesës ndaj vendimeve të saj, si dhe mënyrën e aplikimit të kësaj metodologjie për nevojat e agjencisë. Nga dokumentacioni duhet të jetë evidente deri në ç' masë sistemi i ankesave bazohet në procesin e dëgjimit përmes të cilit agjencia i ofron mundësi të vlerësuarve të komentojnë dhe t'i vënë në pyetje rezultatet e vlerësimit.

Në thelb, agjencia duhet të ofrojë prova se sistemi i ankesave i ofron të vlerësuarve mundësi për të shprehur mendimin e tyre rreth rezultateve të vlerësimit.

2.4 Dokumentacioni shtesë

Ky dokumentacion shtesë duhet të ofrojë një përshkrim të përdorimit të anketimeve, materialit statistikor dhe formave të tjera të dokumentacionit që nuk përmenden diku tjetër. Ky material duhet të jetë publik.

2.5 Procedurat për sisteme të cilësisë për agjenci

Agjencia duhet të dokumentojë se ka mekanizma për sigurimin e brendshëm të cilësisë konform standardeve evropiane për agjenci për sigurimin e jashtëm të cilësisë.

2.6 Reflektime financiare

Është e nevojshme që për agjencinë të bëhet një analizë e arritjeve, dobësive, mundësive dhe rreziqeve, me qëllim që të përshkruhet kapaciteti i agjencisë që t'i adaptohet kërkesave dhe trendeve të reja dhe që, në mënyrë të vazhdueshme, ta përmirësojë aktivitetin e saj, duke ruajtur një kornizë metodologjike dhe një model solid dhe të besueshëm të qeverisjes.

3 Udhëzimet për panelin për vlerësim të jashtëm

Këto udhëzime përshkruajnë pritshmëritë nga paneli për vlerësim të jashtëm. Ato përmbajnë këshilla për:

- emërimin dhe organizimin e përgjithshëm;
- vizitat në terren;
- hartimin e raporteve;

Si është përshkruar më sipër, agjencia që vlerësohet duhet të hartojë një raport vetëvlerësimi në pajtim me udhëzimet e dhëna. Ky studim duhet t'i dërgohet panelit të vlerësuesve të jashtëm jo më vonë se një muaj para vizitës.

3.1 Emërimi i panelit për vlerësim të jashtëm

Këtu përshkruhet emërimi i ekspertëve që duhet ta bëjnë vlerësimin. Grupi për vlerësim të jashtëm duhet të përbëhet nga këta ekspertë:

- një ose dy ekspertë për sigurimin e cilësisë (ndërkombëtarë);
- një përfaqësues i institucioneve të arsimit të lartë (vendor);
- anëtari student (vendor);
- përfaqësuesi i palëve me interes (p.sh. punëdhënës, vendor).

Njëri nga këta ekspertë duhet të zgjidhet kryesues i panelit.

Po ashtu, rekomandohet që panelit t'i shtohet edhe një person nga agjencia, i cili, në kapacitet individual do të kryej detyrën e sekretarit.

Nominimet e ekspertëve mund të vijnë nga agjencitë, palët me interes ose nga autoritetet lokale, por që të sigurohet besueshmëria e vlerësimeve, është me rëndësi që emërimi i ekspertëve t'i besohet palës së tretë, jashtë agjencisë që vlerësohet. P.sh., kjo palë e tretë mund të jetë ENQA ose ndonjë agjenci që nuk është e përfshirë në proces. Baza për verifikimin e besueshmërisë së ekspertëve duhet të jenë deklaratat për paanësinë e tyre. Sidoqoftë, agjencia që vlerësohet duhet të ketë mundësinë për të komentuar rreth përbërjes përfundimtare të panelit.

3.2 Vizitat në terren

Për vizita terreni duhet përgatitur një protokoll me këto elemente:

Rekomandohet që vizitat të zgjasin 2-3 ditë, përfshirë përgatitjen dhe veprimet e mëtutjeshme, varësisht nga njohuria që ka paneli për vlerësim të jashtëm për agjencinë që vlerësohet dhe kontekstin e veprimit të saj. Një ditë para

vizitës, paneli do të takohet dhe do të bien dakord për temat relevante të vizitës. Qëllimi i vizitave në terren është të verifikohet vetëvlerësimi. Udhëzimet për intervistim duhet të hartohen me këtë ide.

Vizitat duhet të përfshijnë takime individuale me anëtarë të bordit të agjencisë, me menaxhmentin, personelin, ekspertët, pronarët/palët me interes dhe përfaqësuesit e institucioneve të vlerësuara në nivelin e menaxhmentit dhe të anëtarëve të komisioneve të brendshme për vetëvlerësim.

3.3 Hartimi i raportit

Përveç përcjelljes së termave të përgjithshme të referencës, raporti duhet të përqendrohet, me saktësi, në përmbushjen e standardeve evropiane për agjenci për sigurimin e jashtëm të cilësisë duke ndjekur protokollin për vetëvlerësim, si dhe në shfrytëzimin e mundësive dhe rekomandimeve për përmirësime të mëtutjeshme.

Pas vizitës, paneli i jashtëm vlerësues, i ndihmuar nga sekretari, do të hartojë një raport. Versioni përfundimtar duhet t'i dërgohet agjencisë së vlerësuar për komente për gabime faktike.